

GAZETA SHQIPTARE



Kryeredaktor: Erl MURATI
Zv/kryeredaktore - Rezarta DELISULA
Tel:(04)2359-104, Fax:(04) 2359-116 E-mail:gazetashqiptare@hotmail.com



Viti XXVI - Nr. 7785 E mërkurë 6 Shkurt 2019 Çmimi, 50 lekë (1.5 euro)

Opinion *i* **Ditës**
Para rreth katër muajsh, kur ende rrugët në bjeshkët e Tropojës ishin të hapura, ndërmora një udhëtim në Dobërdol, që është një ndër perlat alpine ...
Vijon në faqen 20

Nga ADRI NURELLARI
Kur taksat shndërrohen në vjedhje nga ana e shtetit


Opinion *i* **Ditës**
Duke shfletuar dokumente të Dndryshme të historisë sonë të para njëqind viteve, duket sheshit se kontributi i shqiptarëve të diasporës, kryesisht i atyre ...
Vijon në faqen 21

Nga ANDON ANDONI
Diaspora dje dhe sot, për Shqipërinë




Grupi i hetimit: Autorët lanë gjurmë
Vrasja e ish-policit Arben Bilali, gjenden maskat dhe armët në makinën e atentatit

Ekzekutimi i 50-vjeçarit/ Policia gjen shenja gishtash në automjetin me targa të vjedhura
TIRANË-Një javë pas ekzekutimit me kallashnikov të ish-efektivit të policisë, Arben Bilali, zbardhen detaje të reja. Sipas burimeve të TV "Klan", mësohet se personat që qëlluan nga makina e zezë e me targa të huaja mbi 50-vjeçarin në zonën e Selitës në kryeqytet kanë qenë të maskuar. Dy maskat e tyre dhe armët e krimit, dy automatikë ...
Në faqen 11

QEVERIA RILLOGARIT MASEN E PERFITIMIT FINANCIAR PER TRASHEGIMTARET EMRAT, TE PERNDJEKURIT QE MARRIN DEMSHPERBLIMIN

Publikohet vendimi me listën e korigjuar me shumat që përfitojnë ish-të dënuarit politikë. Të dhënat për çdo dosje, kush mori letra me vlerë



(Në foto) Ish-të përndjekur (foto ilustruese) Në faqen 8-10

DEBATET
Komisioni i Ligjeve pranon dekretin e Metës për kadastrën, ku "ndahen" PS e PD
Në faqen 2

DESHTON OPERACIONI
Pasaporta e viza false, si u arratis kreu i trafikantëve, Dritan Gramozi
Në faqen 6

HISTORITE
VIP-at shqiptarë që u njohën me dashurinë e jetës në vendin e punës

HISTORIA
Parise, italiani që vlerësonte Shqipërinë në gazetën "Corriere"
Në faqen 18-19

PRESIDENTI

Meta në Senatin e SHBA: Ndryshimi i vetëm i kufijve në rajon, zgjerimi i BE
Në faqen 3

Lobimi për integrimin: Kryetari i parlamentit gjerman, mik i madh i vendit tonë
Kreu i Bundestagut, Ruçi-Ballës: Shqipëria në BE
Kreu i grupit parlamentar të PS: Gjermania, pro hapjes së negociatave

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi dhe kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla nisën dje veprimtarinë lobuese me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së për çeljen e negociatave në qershor 2019. Gjatë takimit me Presidentin e Bundestagut gjerman,



Schauble, kreu i Kuvendit, Ruçi, e vlerësoi atë si "një mik të madh të Shqipërisë" dhe i shprehu mirënjohjen e thellë për mbështetjen e Bundestagut, qeverisë, Kancelares Merkel dhe atij personalisht, në kuadër të vendimit të Këshillit European për rekomandimin ...
Në faqen 2

INTEGRIMI I SHQIPËRISË LOBIMI NË BE-SHBA

Kreu i grupit të PS: Gjermania, pro hapjes së negociatave për anëtarësim

Kryetari i Bundestagut, Ruçit dhe Ballës: Shqipëria në BE

"Schauble, mik i madh i vendit tonë"

Valentina Madani

Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi dhe kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla nisën dje veprimtarinë lobuese me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së për çeljen e negociatave në qershor 2019. Gjatë takimit me Presidentin e Bundestagut gjerman, Schauble, kreu i Kuvendit, Ruçi, e vlerësoi atë si "një mik të madh të Shqipërisë" dhe i shprehu mirënjohjen e thellë për mbështetjen e Bundestagut, qeverisë, Kancelares Merkel dhe atij personalisht, në kuadër të vendimit të Këshillit Europian për rekomandimin për çeljen e negociatave në qershor 2019. "Populli shqiptar ushqen ndjenja të thella të miqësisë dhe respektit për popullin gjerman dhe Gjermaninë, si lokomotiva ekonomike dhe politike e Europës. Çelja e negociatave të anëtarësimit është beteja jonë kryesore këtë gjashtëmuajor dhe Kuvendi, qeveria, institucionet dhe qytetarët shqiptarë janë unanimisht në mbështetje të këtij procesi. Mbështetja e Gjermanisë për integrimin evropian të Shqipërisë është shumë më tepër se mbështetja e një vendi anëtar të BE-së. Prandaj ne po punojmë që të realizojmë këtë qëllim strategjik kombëtar, duke e merituar mbështetjen e Gjermanisë me avancimin e agjendës integruese dhe realizimin e objektivave në të gjitha prioritetet", u shpreh në takim kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi. Ndërsa, kreu i grupit të PS, Taulant Balla, tha se është një lajm i mirë për Shqipërinë, fakti se në Bundestag ka një shumicë nga grupime të ndryshme politike që mbështesin fillimin e bisedimeve për anëtarësim të Shqipërisë në BE. Siç theksoi Presidenti Schäuble, "e ardhmja e Shqipërisë dhe e Ballkanit Perëndimor është në



Kryetari i Kuvendit, Gramoz Ruçi dhe kreu i grupit parlamentar të PS, Taulant Balla, dje në Bundestag

REFORMA ZGJEDHORE

Lidhur me reformën zgjedhore është e qartë tashmë se drafti i përgatitur me asistencën e vyer të fondacioneve gjermane "Konrad Adenauer" dhe "Friedrich Ebert" është një dokument integral, që adreson plotësisht rekomandimet e OSBE/ODIHR.



Kreu i shtetit, Ilir Meta, dje në Senatit amerikan

INTEGRIMI

Çelja e negociatave të anëtarësimit është beteja jonë kryesore këtë gjashtëmuajor dhe Kuvendi, qeveria, institucionet dhe qytetarët shqiptarë janë unanimisht në mbështetje të këtij procesi. Mbështetja e Gjermanisë për integrimin evropian të Shqipërisë është shumë më tepër se mbështetja e një vendi anëtar të BE-së.

Qytetarët e Kurbinit dhe Bulqizës në protestë, bllokojnë rrugën

Qytetarët e Kurbinit dhe të Bulqizës i janë përgjigjur thirrjes së opozitës duke protestuar kundër qeverisë si shkak të varfërisë dhe largimit të njerëzve jashtë vendit. Protestës në qendër të Bulqizës iu bashkuan edhe minatorët të cilët kërkojnë plotësimin e disa kërkesave. Në Kurbini protestuesit kanë bllokuar rrugën tek rreth rrotullimi i Milotit. Qytetarët e Kurbinit bllokuan autostradën në Milot Banorët e Kurbinit bllokuan rrethrotullimin e Milotit, duke bllokuar autostradën në të dy anët e saj. Qytetarët e mbështetur nga opozita janë bashkuar duke bërë thirrje kundër qeverisë, si shkak të varfërisë, rritjes së çmimeve, falimentimit të biznesit dhe veçanërisht largimit të rinjve nga Shqipëria. Minatorët e Bulqizës dhe qytetarët e kësaj bashkie, protestuan në qendër të qytetit kundër braktisjes që i është bërë kësaj shtrese nga qeveria. Kushtet e mjera të punës, pagat e ulta dhe mosdhënia e statusit, janë disa nga arsytet që i kanë nxjerrë në



rrugë minatorët e qytetit më të varfër në Shqipëri. Protesta e banorëve të Bulqizës mbështet nga opozita, duke vazhduar kështu serinë e protestave në rrethet për të kulmuar me protestën e madhe të 16 shkurtit në Tiranë.

po kontribuon për të ndërtuar një sistem drejtësie profesionale, të paanshëm dhe me integritet. Reforma në drejtësi i ka tejkaluar pritshmëritë e BE për Konferencën e parë Ndërqeveritare dhe se Komisioni i Pavarur i



Basha takon Albin Kurtin: Mosceni territorit të Kosovës

Kryetari i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, priti dje në zyrën e tij kryetarin e Vetëvendosjes Albin Kurti, të cilin e vlerësoi për qëndrimin ndaj kauzës së drejtë të studentëve e pedagogëve dhe protestës së tyre. Basha dhe Kurti ndanë të njëjtin mendim mbi rëndësinë që ka dialogu me Kosovës dhe Serbisë. "Ata ndajnë të njëjtin mendim mbi domosdoshmërinë e moscenimit të integritetit territorial dhe shtetëror të Republikës së Kosovës dhe unitetit politik me të cilin Kosova duhet të përfaqësohet në këtë dialog", thuhet në njoftim. Sipas PD, "Kreu i opozitës shqiptare dhe lideri i Vetëvendosjes shprehën vendosmërinë për t'u qëndruar vlerave dhe standardeve perëndimore, si e vetmja garanci në mbrojtje të interesit më të mirë të Shqipërisë dhe Kosovës".



BASHKËPUNIMI

"Kreu i opozitës shqiptare dhe lideri i Vetëvendosjes shprehën vendosmërinë për t'u qëndruar vlerave dhe standardeve perëndimore, si e vetmja garanci në mbrojtje të interesit më të mirë të Shqipërisë dhe Kosovës".

BE. Fillimi i bisedimeve për anëtarësim është fillimi i një procesi transformimi të thellë". Kryetari i Kuvendit, Ruçi, rishprehu vendosmërinë tonë për të intensifikuar përpjekjet, në mënyrë që të avancojmë me

agjendën e reformave që lidhen me integrimin në BE, duke listuar si prioritarë për vendin reformën në drejtësi, forcimin e shtetit ligjor dhe luftën kundër korrupsionit. "Vetë, si një proces kurajoz dhe unik

Qualifikimit ka marrë 92 vendime, nga 57 të parashikuara në listën prioritarë të gjyqtarëve e prokurorëve. Shumica e organeve të reja të qeverisjes së sistemit janë krijuar ose plotësuar dhe ky proces do të përfundojë brenda pak muajve të ardhshëm". Shqipëria mbështet dialogun Kosovë-Serbi, të ndërmjetësuar nga BE dhe nënvizoi rëndësinë e një marrëveshjeje të dy vendeve për garantimin e një të ardhmeje evropiane.



Presidenti në Senatin Amerikan: Marrëveshja Kosovë-Serbi të ketë garant SHBA dhe BE

Meta: Ndryshimi i vetëm kufitar në rajon është zgjerimi i BE

"Luftë kundër sjelljes malinje të Rusisë"

Valentina Madani

Kreu i shtetit, Ilir Meta, ishte i ftuar nderi në Senatin amerikan nga Kryetari i Komisionit të Mbrojtjes, Senatori Jim Inhofe, për të mbajtur fjalën në forumin me temë: "Sfidat e Rajonit të Europës Juglindore dhe përballja me ndërhyrjen nga Rusia". Ai njohu audiencën me sfidat e sigurisë në rajonin e Europës Juglindore dhe rolin e Shqipërisë në politikën rajonale, qëndrimin e tij mbi bisedimet midis Kosovës dhe Serbisë të ndërmjetësuar nga BE-ja, si dhe përpjekjet dhe reformat e vendit drejt integritetit në Bashkimin Europian. Lidhur me ndërhyrjen e Rusisë dhe rolin e saj në rajon, Presidenti Meta u shpreh se ardhmja rajonin është Europa e Bashkuar dhe NATO-ja, ndërsa Shqipëria dhe shqiptarët duhet të jenë promotorë e integritetit të rajonit në NATO dhe BE. Presidenti Meta tha se Ballkani ka pësuar transformime të thella në dy dekadat e fundit në të cilat janë investuar seriozisht SHBA-ja dhe BE-ja. Një nga investimet më të mëdha dhe të suksesshme ka qenë Pavarësia e Kosovës dhe në vijimësi vendosja e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë në dobi të normalizimit të marrëdhënieve dhe të stabilitetit, paqes dhe sigurisë afatgjatë në rajon. Marrëveshja që mendohet të arrihet mes Kosovës dhe Serbisë është e rëndësishme të çlirojë energji pozitive, të ndihmojë frymën e bashkëjetesës dhe të ndërtojë një të ardhme më të mirë për të dy vendet. Lidhur me ndërhyrjen e Rusisë dhe rolin e saj në rajon, Presidenti Meta u shpreh se e ardhmja rajonit është Europa e Bashkuar dhe NATO-ja, ndërsa Shqipëria dhe shqiptarët duhet të jenë promotorë e integritetit të rajonit në NATO dhe BE. "Teksa vazhdojmë të konsolidojmë demokracinë, shtetin ligjor, luftën kundër krimit të organizuar dhe ndaj ndikimit të huaj që duan të kontrollojnë këtë rajon, ky proces vendimtar nuk është se shkon në të vërtetë krejtësisht i pakontestueshëm. Ne jemi të bin-



Kreu i shtetit, Ilir Meta

DEKLARATA

"Shqipëria ka qenë dhe vazhdon të jetë katalizator jetik për të zgjeruar kufijtë e NATO dhe Bashkimit Europian, pasi ato mbeten bazat e stabilitetit dhe begatisë në Ballkanin Perëndimor. Ndryshimi i vetëm kufitar për të cilin duhet të punojmë ditë e natë në rajonin tonë është zgjerimi i plotë i kufirit europian", - deklaroi z. Meta në Senatin amerikan.

Pronat, Hahn: Po ndjekim nga afër situatën

Eurodeputeti në Bruksel: Po vidhen tokat e minoritetit nga qeveria

Çështja e pronave të minoritetit grek në Shqipëri u bë shkak për një debat dje në Bruksel. Eurodeputeti grek Kostas Chrysogonos kërkoi disa përgjigje, për atë që ai e cilëson si "shpronësimin e tokave të minoritarëve nga qeveria shqiptare". Konkretisht, eurodeputeti grek referohet në "agresivitetin e qeverisë shqiptare me shpronësimin e një zone të gjerë të bregdetit Vlorë-Sarandë, ku përqindja më e madhe i përket minoritarëve grekë". Sipas eurodeputetit grek kjo është një shkelje e rëndësishme dhe kundërshtim me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, dhe se po merren masat që çështja të ndiqet nga drejtësia. Përgjigje mori nga komisioneri për Zgjerim, Johannes Hahn, i cili tha se:



"Komisioni Evropian i jep rëndësi të madhe të drejtës së pronësisë dhe të sundimit të ligjit për të zgjidhur konfliktet pronësore në të gjithë Shqipërinë". "Në raportin e tij vjetor për Shqipërinë, të publikuar më 17 prill të 2018, Komisioni ka deklaruar se vendi nuk ka bërë ende progres në përmirësimin e kuartrit ligjor për regjistrimin, shpronësimin dhe kompensimin e pronave", deklaroi Hahn. "Komisioni është i vetëdijshëm

për shqetësimet e shprehura nga minoriteti grek në Shqipëri mbi zbatimin e të drejtës të pronësisë dhe jemi duke monitoruar nga afër zhvillimet në këtë çështje. Gjithashtu, duke pasur parasysh kompleksitetin dhe rëndësinë e çështjes së të drejtave të pronësisë, Komisioni është duke ofruar ndihmë financiare dhe teknike në vend, për të adresuar mangësitë në këtë fushë", theksoi Hahn.

dur se marrëveshja përfundimtare ndërmjet Kosovës dhe Serbisë do të prodhojë paqe, stabilitet, siguri afatgjatë në rajon dhe pasur SHBA-në dhe BE-në si garantues. Rezultatet e kësaj marrëveshjeje përfundimtare do të thonë se Kosova do të jetë njohur nga Serbia si një shtet i pavarur dhe anëtar me të drejta të plota i Kombeve të Bashkuara. Ndryshimi i vetëm kufitar për të cilin

duhet të punojmë natë e ditë në rajonin tonë është zgjerimi i plotë i kufirit europian në Ballkanin Perëndimor. Pse Shtetet e Bashkuara duhet të jenë të përgjendruara në këtë rajon? Jemi realistë se sfidat gjithnjë e më rritje, me të cilat përballlet SHBA-ja në arenën globale, por jo vetëm ato, tranzicionit e BE-së, si dhe sfidat e brendshme strukturore me të cilat përballlet Aleanca,

kërkojnë dhe meritojnë vëmendje të plotë", deklaroi z. Meta. Ai foli, gjithashtu, lidhur me situatën në Maqedoninë e Veriut dhe konsideroi miratimin nga dy parlamentet të ndryshimit të emrit si një arritje historike që do ta bëjë rajonin më të sigurtë dhe do ta sjellë në pranë BE-së dhe NATO-s, duke theksuar se ky është një proces i rëndësishëm dhe jetik për të ardhmen e tij.

Basha në Krujë: Nuk do të ketë më marrëveshje me Ramën

Kreu i opozitës Lulzim Basha ishte dje në Krujë nga ku fitoi qytetarët të vijnë në 16 shkurt në Tiranë në protestën e opozitës së bashkuar kundër qeverisë "Rama". Basha shkoi derë më derë e bashkëbisedoi me krunatë. Duke i prezantuar planin ekonomik të PD-së, Basha premtoi vende të reja pune, çlirim të ekonomisë dhe zhdukje të krimit. Ai deklaroi se PD-ja do t'i shërbejë qytetarëve që ditën e parë. Nga Kruja e qëndresës kundër Perandorisë Osmane, Basha tha se ka ardhur koha që të çohemi kundër qeverisë. "Do të ulim taksën e naftës, taksën "Rama". Ato miliarda që i ndan me oligarkët do i çojmë tek pensionet, do i çojmë tek rogat. Ne kemi vizionin, ne kemi planin që t'u shërbejmë që ditën e parë. Institucionet janë kapur nga krimi dhe korrupsioni. Vendi sot nuk ka një parlament dhe një qeveri për qytetarët. Ky është vendi për të dhënë një mesazh. 500 vjet më parë një vend i vogël i qëndroi fuqisë më të madhe ushtarake në botë. Pse, sepse ishin të bashkuar, sot ka ardhur koha të çohemi sepse ne kemi kauzën e drejtë. Ne do ta kthejmë Shqipërinë në binarët europianë. Ka ardhur koha të merrni në dorë fatin tuaj. Kjo është thirrja, kjo është ftesa. Asnjë qeveri e asnjë parlament nuk është sovran i këtij vendi. Nuk e thotë vetëm opozita, tani po e thotë bota se Edi Rama dhe qeveria e tij janë produkt i krimit dhe jo votës së shqiptarëve", deklaroi z. Basha. Zgjidhja e opozitës sipas tij është qeveri kalimtare. "Ngrihuni në këmbë jepini dorën njeri-tjetrit dhe e jani në Tiranë të marshoni!", tha Basha.



Pavloulos: Mosrespektimi i minoritetit, pengesë për Shqipërinë në BE

Presidenti i Greqisë, Prokopios Pavloulos i dërgoi shpreh të një mesazh shumë të qartë Shqipërisë, por edhe Maqedonisë e Turqisë, kur bëhet fjalë për integrimin në Bashkimin Europian. Gjatë takimit me homologen e tij, kroate Kolinda Grabar-Kitarovic ai theksoi se tre vendet duhet të plotësojnë detyrimet europiane dhe ligjet ndërkombëtare. Duke u ndalur të Shqipëria, ai shtoi se duhet të respektojë të drejtat e pakicave kombëtare. "Nëse ata duhet të kenë perspektivë europiane, duhet të plotësojnë detyrimet që shtrohen nga legjislatiioni europian. E drejta e pronës përbën një pengesë të pakapërcyeshme për integrimin evropian të Shqipërisë"-deklaroi Prokopios Pavloulos. Mes dy vendeve vitin e kaluar ka pasur disa herë përplasje me deklaratat në lidhje me të drejtat e minoritetit, ndërsa në qershor Shqipëria pret hapjen e negociatave me Brukselin.

**PRONAT
DEBATI**

Komisioni votoi dje pro, por nuk pranoi sugjerimet e presidentit për kadastrën

PS-PD "konsensus" për dekretin e Metës, por ndahen për ligjin

Opozita akuzoi qeverinë se po cenon pronat e shqiptarëve

Komisioni i Ligjeve votoi dje pro dekretrit të Presidentit Ilir Meta, duke pranuar kështu që të rishqyrtojnë edhe një herë ligjin "Për Kadastrën". Mazhoranca dhe opozita bashkuan votat për ta miratuar këtë dekret, megjithëse u ndanë kur erdhi puna tek ajo çfarë duhet të ndryshojë tashmë në ligj. Opozita kërkoi që në ligj të reflektohen të gjitha sugjerimet dhe vërejtjet e ngritura nga presidenti në relacionin shoqëruar të këtij dekreti, ndërsa mazhoranca ishte e vendosur që të mos ndryshojë asgjë në thelb, por të shfrytëzojë rishqyrtimin vetëm për të bërë korrigjimin e afateve që përcaktonte ligji i miratuar në dhjetor. Kjo ka bërë që opozita të braktisë komisionin, ndërsa mazhoranca ka miratuar edhe ndryshimet e ligjit, këtë herë e vetme. Ndërkohë që gjatë diskutimit të këtij dekreti në komision, këshilltari ligjor i kreut të shtetit, Bledar Dervishaj, tha se ligji cenon parimin e sigurisë juridike dhe se titujt e pronësive nuk mund të jenë e drejtë e kadastrës. "Krijohet tension kushtetues, nuk janë në përputhje me jurisprudencën. Biendesh me dispozitat civile të Kodit Civil. Ligji cenon parimin e sigurisë juridike që ofronte ligji i mëparshëm. Saktësimi i titujve të pronësive nuk mund të jetë e drejtë e kadastrës", - tha Dervishaj. Ndërkohë që deputetja socialiste, Klotilda Bushka tha se pretendimet e presidentit nuk qëndrojnë: "Siguria juridike ka të bëjë me garancitë që u jepen qytetarëve. Duhet bërë rregullime në dispozitat kalimtare. Propozojmë miratimin e dekretit të presidentit dhe të bëjmë ndryshime në disa nene të ligjit", - tha ajo. Ndërkohë, deputeti demokrat, Oerd Bylykbashi, tha se me ligjin që ka miratuar mazhoranca nuk rikthen pronën, ndërsa u shpreh se dekreti i presidentit dhe relacioni që e shoqëron atë bën konstatime që qëndrojnë dhe që duhen marrë në konsideratë në rishqyrtimin e ligjit. "Problemi është se si koncepton Edi Rama shtetin, gjithçka në dorën e tij. Me ligjin që keni miratuar, nuk riktheni pronën. Në 6 vjet jeni tallur me shqiptarët. Pasi mbyllni Gjykatën Kushtetuese, vazhdoni të shkatërroni të drejtën pronësore në mënyrë brutale. Këni marrë përsipër në ligjin tuaj, në konceptin tuaj se si mund të grabisni pronën", - tha Bylykbashi. Madje, ai theksoi se ligji në variantin e miratuar i jep të drejtë kadastrës të rishohë titujt e pronësive, duke rre-



BYLYKBASHI
"I jepni të drejtën këtij institucioni të hyjë tek titujt e pronësive. U thoni qytetarëve 'unë po ta gris këtë vendim dhe po ta saktësoj si dua unë'. Keni krijuar një ALUIZNI tjetër. Në babëzinë tuaj shkoni dhe më larg, në një gjë që është shumë keq, siç është saktësimi i titujve të pronësive, e bëni gropë deri në fund".

Raporti i "Freedom Hous": Shqipëria mbetet në vendnumëro

Shqipëria mbetet një vend pjesërisht i lirë edhe për vitin 2018. Është ky klasifikimi që i bën vendit tonë "Freedom House", në raportin e përvitshëm për demokracinë në botë. Krahasuar me një vit më parë, Shqipëria mbeti në të njëjtin nivel, duke mos pësuar as regres e as përmirësim në renditjen e vendeve të lira. Megjithatë, shqetësues mbetet fakti se përveç Hungarisë dhe Serbisë, ku kritikohet fort demokracia, vendi ynë rrethohet në këtë renditje nga vende me probleme të thella në liri dhe të drejta qytetare, si Tunizia, Bolivia apo El Salvadori. Në të njëjtën situatë ndodhet thuajse i gjithë Ballkani, të cilin në hartën e "Freedom House" mund ta shquajmë me ngjyrën e verdhë. Kosova, Maqedonia, Bosnje-Hercegovina mbeten gjithashtu vende pjesërisht të lira. Serbia ka kaluar nga vend i lirë në pjesërisht i lirë, për shkak të parregullsisve zgjedhore, sulmeve ndaj gazetarëve të pavarur dhe mbledhjes de facto të kompetencave jashtëkushtetuese nga ana e Presidentit Vuçiq. Sa i përket Malit të Zi, nënvizohet se presidenti Milo Gjukanoviç vijoi të forcojë pushtetin përrth vetes dhe njerëzve të tij të ngushtë. Në një vëzhgim global, "Freedom House" vlerëson se demokracia ka pësuar regres.



Reforma në drejtësi, Kuvendi shpërblime të majme për komisionerët

Kuvendi ka miratuar në seancën e shkuar një vendim me anë të të cilit bën edhe miratimin e masës së shpërblimit për anëtarët e Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e zbatimit të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisë së sistemit të drejtësisë". Bëhet fjalë për një komision të posaçëm që funksionon pranë Kuvendit dhe që merret me vëzhgimin e procesit të zbatimit të reformës në drejtësi dhe në mënyrë të veçantë të ngritjes së institucioneve të reja të drejtësisë dhe procesin e vetingut. Në total janë 5 anëtarë të zgjedhur nga Kuvendi dhe që sipas këtij vendimi do të paguhen për çdo mbledhje që bëjnë me shumata të konsiderueshme.



Më konkretisht, kryetari i Komisionit të Pavarur për çdo mbledhje në të cilën është prezent përfiton shpërblim në masën prej 30 për qind të pagës mujore bruto të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Ndërkohë që anëtarët e Komisionit të Pavarur për çdo mbledhje në të cilën janë prezent përfitojnë secili shpërblim në masën prej 25 për qind të pagës mujore

bruto të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor ose Këshillit të Lartë të Prokurorisë. Dhe në rast se ky komision do të zhvillojë deri në 3 mbledhje në muaj, atëherë shpërblimi i anëtarëve të këtij komisioni është afërsisht i barabartë me pagën e anëtarit të KLGJ apo KLP-së. Si rregull ky komision duhet të mbledhet minimumi 1 herë në muaj.

zuar në këtë mënyrë pronat e të gjithë qytetarëve shqiptar: "I jepni të drejtën këtij institucioni të hyjë te titujt e pronësive. U thoni qytetarëve 'unë po ta gris këtë vendim dhe po ta saktësoj si dua unë'. Keni krijuar një ALUIZNI tjetër. Në babëzinë tuaj shkoni dhe më larg, në një gjë që është shumë keq, siç është saktësimi i titujve të pronësive, e bëni gropë deri

në fund. Nuk mund të ketë titull që ka në dorë qytetari që t'u vijë përballë. Të këput titulli i ri i pronësive. Ajo letër që ka ai nuk vlen. Kështu më doli mua nga sateliti e do ta marrim". - u shpreh Bylykbashi. Ndërkohë që deputeti Bashkim Fino ironizoi opozitën, duke deklaruar se ajo e konsideron presidentin si të vetin. "Presidenti është i të gjithëve. Ju po e

përdorni politikisht një president që është i të gjithë shqiptarëve", - tha Fino. Pavarësisht pranimit të dekretit, opozita kërkoi të njëjtin ligj, ndërkohë që mazhoranca ofroi vetëm 30 minuta kohë. Në këto kushte, opozita u largua nga salla, ndërkohë që socialistët votuan disa ndryshime që kanë të bëjnë me afatet që parashikon ligji.

Rama në Prezë: Fshati është lënë pas dore, por jemi ende në kohë

Kryeministri Edi Rama zhvilloi dje një vizitë në Prezë. Këtu pa nga afër një nga sipërmarrjet e agroturizmit që ka përfutur nga mbështetja financiare e programeve të qeverisë. Nën shembullin e këtij biznesi, Rama u shpreh se fshati është një mundësi e mirë për të rritur të ardhurat dhe përfitimet përmes agroturizmit. Ai nuk nguroi të shprehë edhe kritika sa i përket vëmendjen ndaj fshatit, duke u shprehur se me të nuk është punuar siç duhet. Gjithsesi, ai u shpreh se skemat fiskale të hartuara nga qeveria do të ndihmojnë të gjithë të interesuarit që të zhvillojnë aktivitetin e tyre ekonomik edhe në fushën e agroturizmit. "Këto shembuj na vlejné si modele. Kjo është rruga e punësimit dhe e fitimit në fshat. Kjo është një industri në vete dhe me shumë perspektivë. Ne siç ju kemi thënë ju: Jemi të angazhuar të japim investime direkte, që shkojnë në promovimin e zonave dhe bukurive natyrore. Ka ikur shumë kohë që mund të ishin ndërtuar skemat për fshatin si të ishte në Toskana, por ende jemi në kohë", - tha Rama.

Raporti BSH, kredia në 2018 u mbyll në rënie, 18 mld lekë më pak

Portofoli i kredisë për ekonominë u zvogëlua edhe gjatë dhjetorit të kaluar, duke mbyllur një tjetër vit kalendarik në rënie. Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, në fund të vitit të kaluar kredia kishte vlerën e 532.6 miliardë lekëve. Gjatë muajit dhjetor, portofoli i kredisë ra me dy miliardë lekë të tjera. Krahasuar me fundin e vitit 2017, portofoli i kredisë për ekonominë është turrur me afro 18 miliardë lekë ose 3.2%. Rënia i

detyrohet pjesërisht efektit statistikor të mbicimit të lekut në kursin e këmbimit, që e ka ulur vlerën e konvertuar të kredisë në euro. Gjithashtu, sidomos në muajt e fundit të vitit, ndikim jep edhe fshirja e kredive të humbura, sipas kërkesave rregulatore të Bankës së Shqipërisë, megjithëse ndikimi i këtij faktori vlerësohet të ketë qenë modest krahasuar

me vitet e mëparshëm. Vetëm segmenti i individëve duket të ketë një rritje vjetore të qëndrueshme dhe të shëndetshme. Kreditimi i biznesit dhe tjetër. Edhe gjatë dhjetorit, kredia në këtë segment ra me 2.5 miliardë lekë, ndërsa krahasuar me një vit më parë rënia është rreth 12 miliardë lekë. Megjithëse me të drejtë, bankat po tentojnë ta diversifikojnë kreditimin

në segmentin e shitjeve me pakicë, gjallërimi i kredisë për biznesin, sidomos për atë të madh, do të jetë i domosdoshëm për të rritur volumet e huadhënies. Totali i kredisë për ekonominë sot është në vlera të përafërta me fundin e vitit 2011. Gjatë shtatë viteve të fundit, kredia ka regjistruar vetëm rënie ose stanjacion. Në terma realë, kredia sot vlerëso-



het në rreth 32% të PBB-së, nga rreth 42% që zinte në vitin 2011. Me gjithë uljen e raportit të kredive me proble-

leme dhe një gjallërim të aktivitetit ekonomik, sërish kreditimi i biznesit është i dobët.

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës: Projekti i përmirësueshëm, jo i anulueshëm

"Unaza", Balluku: Do vijojë, askush nuk mund të marrë peng Tiranën

Procesi i shpronësimeve vijon sipas ligjit

Projekti i "Unazës së Re" do të vijojë, pavarësisht situatave që e kanë shoqëruar atë. Ministria e Infrastrukturës dhe Energjinë, Belinda Balluku, në një dalje para mediave tha dje se projekti në vetvete është kompleks, por ai do të vazhdojë. Sipas saj, projektin mund t'i bëhen përmirësime, por ai nuk do të anulohet. Për të parë një zgjidhje më të mirë, ministrja nënvizoi se specialistët dhe bashkia janë ulur në një tryezë të përbashkët për të gjetur një zgjidhje sa më adaptive për lotin 3. Ministria nënvizoi gjithashtu se asnjë familje që preket nga zbatimimi i këtij projekti nuk do të lihet në mes të rrugës.

DEKLARATA

Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Belinda Balluku deklaroi në një dalje për mediat se projekti i "Unazës së Re" nuk është anuluar. Ajo u shpreh se askush nuk mund ta mbajë peng Tiranën, ndërsa shtoi se ARRSH nga soto do të jetë e detyruar që garat t'i bëjë publike dhe në transmetim të drejtëpërdrejtë. "Arsyeja se përse po komunikoj me ju është nevoja për t'u dhënë fund aludimeve, deklaratave dhe lajmeve të rreme mbi projektin e 'Unazës së Re' për t'i bërë të qartë njëherë e mirë kujtdo se projekti është i përmirësueshëm, por jo i bllokueshëm e aq më pak i anulueshëm. Tiranë dhe e gjithë Shqipëria që kalon në atë segment kur vjen në kryeqytet s'mund të merret peng nga askush dhe për asnjë arsye. Është folur dhe është stërfolur për kosto dhe kilometra, por projekti është tejet kompleks dhe me një numër të konsiderueshëm nyjash, vepra arti në një distancë relativisht të shkurtër, por ama në mes të një zone të mbipopulluar, ku intensiteti i banimit dhe aktivitetit do të shkojë duke u rritur", tha Balluku.

SHPRONËSIMET

"Procesi i shpronësimeve vijon sipas ligjit, familje në mes të katër rrugëve nuk do të lemë. Bashkia pak ditë më parë ka kaloi 8 plane zhvillimi për parcela buzë 'Unazës'. Iu jep banorëve mundësinë e zhvillimit të pronës kur janë në shtëpi pa biznes. Loti i tretë do të ketë një tryezë me specialistë me Bashkinë e Tiranës dhe ekspertë. Duke mospërshtuar rishikimin,



Ministria e Infrastrukturës dhe Energjetikës, Belinda Balluku

nëse ka vend për rishikimin për projektin. Fokusit do të jetë të nyja strategjike, nyja e 'Shqiponjës'. I kam kërkuar ARRSH të përgatitet për çdo garë të jetë 'live' para kamerave dhe në sytë e pub-

likut", tha ajo. Aktualisht projekti për "Unazën e Madhe" ka shfaqur problematika, duke nisur nga rezistenca e banorëve që preken, të cilët prej muajsh janë në protestë e deri te loti i parë ende

nuk ka një kompani zbatuese pas skandalit me "DH Albania" dhe rishpallje së garës. Në garën e dytë vetë Autoriteti Rrugor Shqiptar konfirmoi se kompanitë pjesëmarrëse nuk plotësonin kushtet e vendosura, çka bëri që të s'kualifikoheshin të gjitha ofertat. "Komisioni i Vlerësimit të Ofertave u ka ofruar të gjitha kompanive skualifikimin e ofertave të paraqitura. Sot do t'i paraqitet ministres Balluku një proces transparent. Kompanitë janë partnere të ARRSH-së, dialogu dhe transparencja do të jetë parësore. Kompanitë kanë të drejtën të animojnë. Në lotet e tjera të projektit do vijojnë punimet dhe shpronësimet, pasi ky projekt do të realizohet", do të nënvizonte drejtorja e ARRSH, Sonila Qato, javën e shkruar.

Tatimet, ja rastet ku sekuestrohet pasuria

Drejtorja e Përgjithshme e Tatimeve në rubrikën "tatimet këshillojnë" ka publikuar rastet e mblledhjes me forcë të detyrimit të papaguar të tatimpaguesve. Sekuestrimi i pasurisë dhe urdhri i sekuestrim-it Administrata Tatimore në zbatim të dispozitave të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, në lajmërimin për pagimin e detyrimeve tatimore njofton tatimpaguesin për afatit kohor që ai ka në dispozicion për t'i paguar vullnetarisht. Kur konstatohet se nga ana e tatimpaguesit nuk është paguar detyrimi brenda këtij afati kohor, administrata tatimore përveç bllokimit të llogarive bankare të tatimpaguesit, nxjerr njoftimin për fillimin e pro-



cedurave të mblledhjes me forcë të detyrimit tatimor, si dhe merr masat për sigurimin e pasurisë së tij, duke vendosur mbi sendet në pronësi të tatimpaguesit, barrë siguruese apo hipotekë. Nëse shumat që kalojnë në llogari të Administratës Tatimore pas urdhërimit të bllokimit të llogarive, nuk plotësojnë detyrimin tatimor

të papaguar të tatimpaguesit, AT sekuestron dhe më pas konfiskon, në favor të saj, të gjitha sendet e luajtshme të të paluajtshme në pronësi të tatimpaguesit, ndaj të cilave ajo ka vendosur më parë barrën siguruese apo hipotekë. Çdo veprim i kryer për tjetërsim të pasurive të luajtshme apo të paluajtshme të të tretëve nga data e nxjerrjes së njoftimit vlerësimit tatimor prej tatimpaguesit do të konsiderohet nga Administrata Tatimore si i pavlefshëm dhe detyrimi për arkëtimin e këtij detyrimi tatimor do të shtrihet edhe tek personat në emër dhe për llogari të të cilëve ka kaluar kjo pasuri.



Ulet numri i vonesave në fluturime

AAC: Kompensohen 700 pasagjerë për janarin

Ujja e fluksit të lëvizjes së pasagjerëve drejt dhe nga Aeroporti Ndërkombëtar "Nënë Tereza" ka sjellë një rënie të numrit të vonesave dhe anulimeve të fluturimeve gjatë muajit janar. Sa u takon kompensimeve, AAC raporton se janë gjithsej 700 kompensime në total, i njëjti me atë të muajit dhjetor. Ndërkohë, pritet që numri i tyre të rritet edhe më shumë, pasi sipas AAC-së janë pranuar nga kompanitë ajrore rreth 1200 formularë të tjerë ankimi. "Viti 2018 shënoi rritje të madhe të numrit të pasagjerëve krahasuar me vitet e mëparshme. Trafiku ajror ka ardhur në rritje të vazhdueshme dhe fluksi i udhëtarëve është shtuar ndjeshëm. Por përveç një kërkese në rritje të pasagjerëve që udhëtojnë nga dhe drejt TIA-s, viti 2018 shënoi edhe rritjen e numrit të kompanive të cilat operojnë me fluturimet e tyre në Shqipëri, duke krijuar edhe destinacione të reja në shërbimet e tyre. Sipas të dhënave zyrtare, në vitin 2018 u arrit një shifër rekord për sa i përket numrit të pasagjerëve që kanë udhëtuar nëpërmjet linjave ajrore për/ nga vendi ynë. 2,947,172 ishte numri i pasagjerëve përgjatë këtij viti, numër ky 12% më i lartë se ai i një viti më parë, ku shifrat shkuan në 2,630,338 pasagjerë. Pjesë e rëndësishme e të dhënave në rritje tashmë është edhe numri i lartë i turistëve të huaj të ardhur në vendin tonë, si dhe numri i kompanive të fluturimeve charter, të cilat përgjatë muajve të verës rritën ndjeshëm jo vetëm numrin e pasagjerëve, por edhe numrin e destinacioneve të reja.

Njoftim për shitje me ankand te Il

Shoqëria "Power & Justice" (P&J) sh.p.k në datë 01.02.2019 ka shpallur ankandin e dytë të pasurisë të palës debitore Shoqëria "ARNI" sh.p.k. Pauria që del në ankand të dytë përbehet nga:

1. "Apartamenti", me Nr pasurie 69/11/ND +1-14 ndodh Rr "Dodona", Hyrja nr.1, Kati 3 Zyra nr.5

2. "Orkum e regjistruar në ZVRFP- Vlore, Z K Nr.2832, volumi 16, faqe 120, me sipërfaqe 43m2.

Ankand i pasurisë fillon me çmimin fillestar në masën 1.344.000 lekëAnkand do të zhvillohet në datë 04.03.2019 në orën 15:00 në selinë Bul "Gjergj Fishta" Kulla 1, Kati 2, Zyra nr.5. Kontakti 0672082543, ilir_dervisha@yahoo.com, faqen WEB www.powerjustice-all.com

Operacioni "Rruga e gabuar" u dekonspirua. Lihen në qeli 22 prej të arrestuarve

Me pasaporta e viza false drejt SHBA e BE, ja si u arratis kryetrafikanti Dritan Gramozi

Ishte duke pirë kafe sy të agjentëve civilë dhe nuk u kap. Tentoi arratisjen edhe anëtarë i "Avdylëve", Hajri Seferi

TIRANË

Pak ditë pas arrestimit të 32 personave si pjesë e një grupi kriminal që kontrabandonin njerëz drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe Britanisë së Madhe janë zbardhur detaje të reja në lidhje me operacionin e koduar "Rruga e gabuar". Mësohet se mes personave të vënë në pranga nga policia nuk është i dyshuari kryesor apo i etiketuar si "koka" e grupit. Bëhet fjalë për Dritan Gramozin, i cili është arratisur pak para se të finalizohet operacioni. Mësohet se 44-vjeçari është mbajtur në vëzhgim nga policë civilë, por është e pakuqteshme se si ai arriti të shpëronte. Ndërkohë që gjatë seancës së djeshme gjyqësore në Gjykatën e Krimeve të Rënda ku u dha masa e sigurisë për 32 të arrestuarit janë ngjitur dyshime për dekonspirimin e aksionit. Në lokalitetin ku pinte kafe Gramozi, pavarësisht se ai nuk u kap, policia arriti të arrestojë një tjetër të dyshuar, shtetasin Rezart Hoxha. Për arratisjen e tij nuk ka ende një shpjegim nga policia. Nga dosja e Prokurorisë del se, Dritan Gramozi është njeriu që prodhonte dhe siguronte dokumente të falsifikuara, jo vetëm karta identiteti, por edhe pasaporta greke, italiane, bullgare dhe çeke. Ai pasi i gjente përmes bashkëpunëtorëve të tij personat që do të udhëtonin në mënyrë të paligjshme, u mundësonte atyre edhe kalimin e paligjshëm përmes pikave të Qafë-Bohtës dhe Kakavijës. Mënyra më speciale e ndërhyrjes në dokumente është ajo e fshirjes së vulave për çdo person, i cili ishte deportuar nga vendet e Bashkimit Europian.



Dritan Gramozi



Seanca e djeshme gjyqësore

DRITAN GRAMOZI
Nga dosja e prokurorisë del se Dritan Gramozi është njeriu që prodhonte dhe siguronte dokumente të falsifikuara, jo vetëm karta identiteti, por edhe pasaporta greke, italiane, bullgare dhe çeke. Ai pasi i gjente përmes bashkëpunëtorëve të tij personat që do të udhëtonin në mënyrë të paligjshme, u mundësonte atyre edhe kalimin e paligjshëm përmes pikave të Qafë-Bohtës dhe Kakavijës. Mënyra më speciale e ndërhyrjes në dokumente është ajo e fshirjes së vulave për çdo person, i cili ishte deportuar nga vendet e Bashkimit Europian.

GABIMI I POLICISË

Seanca e djeshme gjyqësore të Krimit e Rënda ka nisur me lirinë e njërit prej personave, që gabimisht kishte përfunduar në burg. Bëhet fjalë për 56-vjeçarën Enver Muka, i cili edhe pse ishte shpallur në mungesë në arrest shtëpiak, u shfaq në të njëjtin kafaz me të arrestuarit që u sollën nga paraburgimi. Menjëherë pasi gjykata konstatoi këtë shkelje (policia kishte gabuar me procedurat) urdhëroi lirinë e Mukës, i cili nuk e shpjegoi dot se si përfundoi në paraburgim.

MASAT E SIGURISË PËR PERSONAT E PËRFSHIRË NË GRUPIN KRIMINAL

ARREST ME BURG

- | | |
|--------------------|--------------------|
| 1. Petrit Beqiraj | 12. Çajup Tafa |
| 2. Ermal Mema | 13. Arjon Shehu |
| 3. Vesel Gjollëshi | 14. Afrim Emini |
| 4. Dashnor Tafani | 15. Mentor Meci |
| 5. Arben Danglli | 16. Gjergji Mezura |
| 6. Leonard Markaj | 17. Françesk Meta |
| 7. Dashamir Seferi | 18. Aleksia Kamaj |
| 8. Enver Muka | 19. Mehmet Cani |
| 9. Idi Mita | 20. Eriç Shehu |
| 10. Glej Shehu | 21. Edmond Omeri |
| 11. Ilia Margo | 22. Kostaq Gjoka |

ARREST ME BURG ME AFAT 1-MUJOR PËR POLICIN ELMAS BILBILI

ARREST SHTËPIE

1. Arjan Shehu
2. Jonaq Gramozi
3. Vangjel Gramozi
4. Simon Këri
5. Enver Muka
6. Idi Mita
7. Shuaip Shero

DETYRIM PARAQITJE

1. Bedri Meta
2. Avni Vezajn
3. Astrit Zigurin
4. Besnik Hoxhën
5. Marlen Shoshaj

persona. Gjithashtu, provohet se kjo organizatë nuk ka ndihmuar vetëm këtë të kërkuar, por në kohë të ndryshme ata kanë ndihmuar për kalim kufiri si nga pikat doganore, por edhe nga vija e gjelbër persona të ndry-

shëm, me probleme me ligjin apo që kishin shkelur afatet e "Schengen"-it. Ata u sigurorin të shumëkërkuarve dokumente të falsifikuara dhe i ndihmonin ata që të kalonin kufirin, me qëllim që t'i shpëtonin drejtësisë. Sipas

Përgjimet, si kalohej kufiri me Greqinë, shoqëruar me makinë policie

TIRANË - "Gazeta Shqiptare" ka zbardhur një pjesë të përgjimeve në dosjen e Prokurorisë mbi arrestimin e 32 personave në kuadër të operacionit "Rruga e gabuar". Grupi kriminal kontrabandote njerëz drejt Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Kanadasë dhe Britanisë së Madhe kundrejt shumave deri në 20 mijë dollarë. Klandestinët pajiseshin me pasaporta dhe udhëtonin në pas drejt destinacioneve të kërkua, si SHBA dhe Kanada. Ndërkohë drejt Britanisë së Madhe udhëtonin me pasaporta të falsifikuara të vendeve të BE-së, siç thuhet në dosjen e Prokurorisë. Në dosjen në



fjalë përmenden raste konkrete ku anëtarë të këtij grupi ndihmonin njerëz të ndryshëm të kalonin kufirin me mënyra të paligjshme. Kështu rezultoi se në datë 24.01.2019, anëtarët e grupit të identifikuar si Vesel

Gjollëshi, Çajup Tafa dhe Sefer Çelo kanë ndihmuar të kalojnë në pikën e Kakavijës një burrë dhe një grua, bashkë me një fëmijë. Në këto përgjime del edhe emri i një tjetër anëtarë të grupit, shtetasi Marsel Shoshaj, me të cilin tre të parët janë takuar në një karburant në dalje të Gjirokastrës, pasi janë siguruar se "klientët" e tyre e kishin kaluar kufirin. Madje, interesant është fakti që dy klandestinët i shoqëronte drejt kufirit anëtarë të grupit, Çajup Tafa, ndërsa nga pas i ndiqte një makinë policie me targa MB498AA, që e drejtonte anëtarë tjetër Sefer Çelo.

prokurorisë, grupi kriminal prej 36 personash në bashkëpunim me Elmas Bilbilin, efektivi policie në pikën kufitare të Kakavijës u jepnin ndihmë për kalim kufiri personave me probleme apo me precedentë penalë kundrejt shpërblimeve të ndryshme, që nga përgjimet faktohet se shkojnë deri në 2 mijë euro. Përgjimet nxjerrin në dritë

edhe fakte të tjera për mënyrën sesi rrjeti funksiononte për të kontrabanduar qytetarët, disa prej të cilave janë ndaluar në Xhamajkë apo aeroporte të ndryshme të vendeve të Bashkimit Europian. Ndërkaq, pas një seance gjyqësore maratone (ka zgjatur plot 12 orë), Gjykata e Krimeve të Rënda ka vendosur masën e sigurisë

"Arrest me burg" për 22 nga 32 personat e arrestuar gjatë operacionit të koduar "Rruga e gabuar", ndërsa ka vendosur masën e sigurisë "Arrest shtëpie" për 7 persona si dhe masën e sigurisë "Detyrim paraqitje" për 5 të tjerë. Kurse ndaj policit Elmas Bilbili është vendosur masa e sigurisë "Arrest me burg" me afat 1-mujor.

SITUATA GRIPALE KËSHILLAT E MJEKES

"Rastet e vdekjeve, pacientët kanë pasur komplikacione të rënda respiratore"

Gripi në vend, mjekja: Ja cilat janë kategoritë më të riskuara, si të mbroheni

Najada Çoma: Shifrat, deri në 100 të sëmurë në ditë

Deri më tani, ka pasur tri raste vdekjesh si pasojë e gripit, por të sëmurët kanë shfaqur më parë komplikacione të rënda respiratore. Mjekja Najada Çoma e ftuar në rubrikën "Opinion" në News 24 ka folur për përhapjen e gripit gjatë kësaj periudhe, si dhe ka dhënë këshilla se si duhet të vepronin qytetarët për të mbrojtur veten dhe të tjerët.

Sipas saj, mënyra më e mirë për qytetarët që të mbrohen nga gripi sezonal, është të shmangin vendet e frekuentuara nga shumë njerëz si dhe paraqitjen në spital kur gjendja e tyre është e rënduar. Çoma tha se gratë shtatzënë dhe personat që vuajnë nga sëmundje kronike duhet të kenë një kujdes të veçantë. "Lokalet janë vendet ku mbledhja e njerëzve është më e lartë dhe bëhet kalimi përmes rrugëve ajrore. Një person që është i shëndetshëm dhe nuk është ekspozuar nuk është e nevojshme bërja e vaksinës. Marr shkas për t'ju bërë thirrje që kur shoqëroni një person të sëmurë, nuk duhet ta shoqërojnë shumë persona, sepse duke e shoqëruar ekspozohesh vetë. Kjo ka vlerë të madhe që ul transmetimin nga njeriu i sëmurë te ai i shëndetshëm. Edhe gratë që janë shtatzënë rrezikojnë shumë, kemi pasur një rast shumë të rënduar. Një grua në muajin e tetë, në sajë të punës sonë ajo grua dhe femija e saj janë mirë tani",-u shpreh ajo.

SITUATA GRIPALE NË VEND

Mjekja sqaron se gripi është një sëmundje sezonale që zgjat për 3 muaj e ka këshilluar qytetarët që vizitën e parë ta kryejnë te mjeku i familjes. "Gripi është sëmundje sezonale, ka filluar rreth ditëve të parë të muajit janar. Pra, pritshmëritë që të themi dy fjalë për gripin është një sëmundje sezonale që zgjat në një periudhë tre muajore. Gripi ka filluar në ditët e parë të janarit, për ne është normale ndërsa për popullatën jo, sepse sëmundjen gjerësisht. Gripi ndodh vetëm njëherë në sezon. Vendi i parë që bëhet vizita mjekësore është mjeku i familjes dhe fluksi i njerëzve është më i shtuar, ka një diferencë sa paraqiten në urgjencën tonë është 90 ose 100 raste në ditë. Natyrisht nga ata që vijnë



Foto ilustruese

RASTET FATALE

"Është një sëmundje nga e cila kemi pasur edhe vdekje. Mendoj që vdekja e tyre ka ardhur nga insuficenza respiratorike. Në numër dhe shifra mund të duket pak për ne është shumë e lartë. Edhe gratë që janë shtatzënë rrezikojnë shumë, kemi pasur një rast shumë të rënduar", - bën me dije Çoma.



nuk janë për t'u shtruar në Infektiv. Ajo që referohet fort nga ana mjekësore është shtrimi i rasteve në reanimacion",-thekson Çoma. Kjo e fundit paralajmëron pacientët mbi simptomat kryesore të gripit dhe komplika-

cionet që mund të kenë. "Shenja është temperatura nëse kalon dita e pestë dhe temperatura vazhdon kemi një rëndësi të situatës së gripit dhe kërkon konsultën me specifike mjekësore. Tre organet që jep komplikacio-

net që prek është ajo e aparatit respirator, zemrën dhe prekjeja e aparatit minonig",-bën me dije mjekja.

KATEGORITË E PREDISPOZUARA

Mjekja Çoma sqaron, gjithashtu, se cilat janë kat-

MASAT

Mënyra më e mirë për qytetarët që të mbrohen nga gripi sezonal, është të shmangin vendet e frekuentuara nga shumë njerëz si dhe paraqitjen në spital kur gjendja e tyre është e rënduar. Çoma tha se gratë shtatzënë dhe personat që vuajnë nga sëmundje kronike duhet të kenë një kujdes të veçantë.

sëmurë, nuk duhet ta shoqërojnë shumë persona, sepse duke e shoqëruar ekspozohesh vetë. Kjo ka vlerë të madhe që ul transmetimin nga njeriu i sëmurë te ai i shëndetshëm",-thekson Çoma.

RASTET FATALE

Sipas mjekes, virusi që ka shkaktuar pandeminë në vitin 2009, është AH1N1, ndërsa këtë herë nga rezultatet laboratorike në popullatë rezultojnë që kemi të bëjmë me grip sezonal. "Nuk duhet anashkaluar, është një sëmundje nga e cila kemi pasur edhe vdekje. Nuk marr përsipër të komentoj rastet e vdekjes, se kanë qenë shtruar në një reanimacion tjetër. Dhe mendoj që vdekja e tyre ka ardhur nga insuficenza respiratorike. Në numër dhe shifra mund të duket pak për ne është shumë e lartë. Edhe gratë që janë shtatzënë rrezikojnë shumë, kemi pasur një rast shumë të rënduar, një grua në muajin e tetë të shtatzënisë, në sajë të punës sonë ajo grua dhe femija e saj janë mirë tani",-bën me dije Çoma.

ISHP, apel prindërve: Vaksinoni fëmijët

Alarmi, arrin në 51 numri i të prekurve nga fruthi në vend

Që prej datës 1 janar deri në 5 shkurt të këtij viti, fruthi ka prekur plot 51 persona në vendin tonë. Statistikat janë bërë publike ditën e djeshme nga Instituti i Shëndetit Publik, i cili thekson se grupmosha më e prekur janë fëmijët nën 2 vjeç dhe rastet më të mëdha janë konfirmuar në Tiranë. Më tej, Instituti i Shëndetit Publik i ka bërë thirrje prindërve që të vazhdojnë vaksinimi i fëmijëve sipas grupmoshave 1 dhe 5-vjeçare, në mënyrë që të shman-

51

TË PREKUR NGA FRUTHI

Që prej datës 1 janar deri në 5 shkurt të këtij viti, fruthi ka prekur plot 51 persona në vendin tonë. Statistikat janë bërë publike ditën e djeshme nga Instituti i Shëndetit Publik, i cili thekson se grupmosha më e prekur janë fëmijët nën 2 vjeç.

gin komplikacionet.

APELI

"Instituti i Shëndetit Publik ju bën thirrje të gjithë prindërve të vaksinonjë fëmijët e tyre sipas kalendarit kombëtar të

vaksinimit dhe udhëzimeve të ISHP-së për grupet që janë më të rrezikuara. Jo vetëm fëmijët, por edhe të rriturit që nuk janë vaksinuar ndaj fruthit apo nuk kanë marrë dy doza të



vaksinës, duhet të vaksinohen. Vaksinimi ndaj fruthit është mbrojtja më e mirë për parandaluar fruthin dhe komplikacionet që vijnë prej tij. Për shkak se kjo periudhë e vitit

sjell rritje të numrit të rasteve të infeksioneve respiratore dhe gripit, bëhet akoma më i rëndësishëm vaksinimi, për të parandaluar përhapjen e fruthit",-sqaron ISHP.

Ish-të dënuarit me burgim dhe me pushkatim, del lista me emrat e 77 përfituesve të parë

Të përndjekurit politikë, qeveria korrigjon masën e dëmshpërblimit

Nga shuma përfundimtare zbriten lekët që janë marrë më parë

Qeveria korrigjon masën e dëmshpërblimit për të përndjekurit politikë që janë dënuar me burgim apo me dënime kapitale me varje ose pushkatim. Në mbledhjen e fundit të Këshillit të Ministrave miratohi ndër të tjera edhe vendimi për korrigjimin e masës përfundimtare të dëmshpërblimit financiar për një kategori të caktuar të dënuarish politikë gjatë regjimit komunist, duke marrë kështu në konsideratë ankimmimet e tyre për rillogaritje të shumës së dëmshpërblimit. Bëhet fjalë për korrigjimin e masës përfundimtare të dëmshpërblimit financiar, të parashikuar në vendimet nr. 1699, datë 29.12.2008; nr. 707, datë 23.6.2009; nr. 784, datë 1.7.2009; nr. 1147, datë



25.11.2009; nr. 1231, datë 11.12.2009; nr. 268, datë 21.4.2010; nr. 382, datë 19.5.2010; nr. 714, datë 25.8.2010; nr. 1015, datë 10.12.2010; nr. 61, datë 26.1.2011; nr. 99, datë 4.2.2011; nr. 135, datë 23.2.2011; nr. 196, datë 9.3.2011; nr. 297, datë 14.4.2011; nr. 363, datë 4.5.2011, të ndryshuar; nr. 509, datë 13.6.2013, nr. 502, datë 10.6.2015, nr. 688, datë 22.11.2017 dhe nr. 256, datë 9.5.2018, të miratuar më parë qeveria dhe që kanë

pasur probleme me përllogaritjen e vlerës së dëmshpërblimit në raport me masën e dënimit që kanë pasur si dhe duke i zbritur përfitimet e tjera që mund të kenë pasur në letra me vlerë apo si banesë e objekte të tjera. Në total nga ky vendim i qeverisë përfitojnë 77 persona dhe tabela shoqëruese pasqyron vitet apo çdo masë tjetër dënimi, shumën e përllogaritur më parë dhe shumën e dalë pas korrigjimit.

LISTA E TË DËNUARVE POLITIKË ME DËNIM ME BURGIM/KAPITAL ME GABIM NË SHUMA VKM NR. 1699, DATË 29.12.2008

Nr. rendori përfshirë VKM	Nr. i dosjes individuale	Data e dosjes individuale	Emër	Mbiemër	Atësi	Amësi	Datëlindja	Vendlindja	Gjinia	Periudha e plotë e vuajtjes së dënimit/apo koha e ekzekutimit	Shuma e dëmshpërblimit në lekë	Përfitimet nga ligje të mëparshme				Dëmshpërblimi përfundimtar	VËREJTJE	Nr. i vendimit të Këshillit të Ministrave
												Ministria e Financës		Enti Kombëtar i Banesave	ZQPPP			
												Lekë	Letra me Vlerë					
												Lekë	Letra me Vlerë					
68	235	06.02.2008	Muço	Bocaj	Ramadan	Emine	04.09.1941	Vlorë	M	4 vjet 1 muaj 3 dite	2988000	500000	500000	0	0	1988000	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008 ndryshuar me VKM 852 datë 05.09.2008
	235	06.02.2008	Muço	Bocaj	Ramadan	Emine	04.09.1941	Vlorë	M	4 vjet 1 muaj 3 dite	2988000	0	500000	0	0	2488000	Bëhet	
115	506	12.02.2008	Haki	Bulku	Jonuz	Hajrije	15.01.1942	Tiranë	M	11 vjet 8 muaj 13 dite	8552000	800000	1215014	941000	0	5595986	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	506	12.02.2008	Haki	Bulku	Jonuz	Hajrije	15.01.1942	Tiranë	M	11 vjet 8 muaj 13 dite	8552000	200000	1215014	941000	0	6195986	Bëhet	
133	584	12.02.2008	Demir	Abazi	Hamit	Hysnije	20.01.1948	Tiranë	M	9 vjet 2 muaj 21 ditë	6736000	0	2214576	0	0	4521424	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	584	12.02.2008	Demir	Abazi	Hamit	Hysnije	20.01.1948	Tiranë	M	9 vjet 2 muaj 21 ditë	6736000	0	1107288	0	0	5628712	Bëhet	
207	883	15.02.2008	Adem	Pira (Piri)	Dine	Shkurte	18.05.1909	Kishavec	M	1 vit 2 muaj 29 ditë	912000	150000	264981	0	150000	497019	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	883	15.02.2008	Adem	Pira (Piri)	Dine	Shkurte	18.05.1909	Kishavec	M	2 vjet 3 muaj 15 ditë	1676000	150000	264981	0	150000	1111019	Bëhet	
232	1081	18.02.2008	Xhaferr	Mehmeti	Shefki	Xhemile	08.10.1927	Milec	M	16.10.1952-15.08.1964	8648000	600000	2441206	0	0	7027397	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008 ndryshuar me VKM 497 datë 25.07.2012
	1081	18.02.2008	Xhaferr	Mehmeti	Shefki	Xhemile	08.10.1927	Milec	M	16.10.1952-15.08.1964	8648000	200000	1220603	0	0	7227397	Bëhet	
245	1170	19.02.2008	Mlito	Vako	Kristaq	Paroke	30.03.1930	Pogradec	M	6 vjet 9 muaj 25 ditë	4988000	400000	718630	0	100000	5789570	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	1170	19.02.2008	Mlito	Vako	Kristaq	Paroke	30.03.1930	Pogradec	M	6 vjet 9 muaj 25 ditë	4988000	100000	718630	0	0	4169370	Bëhet	
516	3025	07.03.2008	Gjin	Picaku	Pjeter	Mare	01.09.1912	Rrëshen	M	10 vjet 6 muaj 16 ditë	4624000	100000	1266740	0	0	3257260	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	3025	07.03.2008	Gjin	Picaku	Pjeter	Mare	01.09.1912	Rrëshen	M	10 vjet 6 muaj 16 ditë	5136000	100000	1266740	0	0	3769260	Bëhet	
721	4669	26.03.2008	Avdulla	Lici	Shefqet	Resmije	15.04.1929	Korçë	M	4 vjet 8 muaj 10 ditë	1562000	400000	460548	0	0	701452	Ishte	miratuar me VKM nr. 1699, Date 29.12.2008
	4669	26.03.2008	Avdulla	Lici	Shefqet	Resmije	15.04.1927	Korçë	M	4 vjet 8 muaj 10 ditë	3436000	400000	460548	0	0	2575452	Bëhet	
913	7217	10.04.2008	Zenel	Dervishi	Sabri	Haxhire	10.05.1922	Cangonjë-Korçë	M	12 vjet 9 muaj 10 ditë	2490000	200000	1334027	0	0	955973	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	7217	10.04.2008	Zenel	Dervishllari (Dervishi)	Sabri	Haxhire	10.05.1922	Cangonjë-Korçë	M	12 vjet 9 muaj 10 ditë	8716000	200000	1334027	0	0	7181973	Bëhet	
991	7935	18.04.2008	Lazer	Shkurtaj	Ndrek	Prende	29.12.1950	Shkodër	M	5 vjet 9 muaj 20 ditë	4248000	0	3011833	0	0	1236167	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	7935	18.04.2008	Lazer	Shkurtaj	Ndrek	Prende	29.12.1950	Shkodër	M	5 vjet 9 muaj 20 ditë	4248000	0	550000	0	0	3698000	Bëhet	
992	7936	18.04.2008	Ndrek	Shkurtaj	Kol	Ruke	05.03.1925	Shkodër	M	9 vjet 3 muaj 20 ditë	6800000	0	3011833	0	0	3788167	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	7936	18.04.2008	Ndrek	Shkurtaj	Kol	Ruke	05.03.1925	Shkodër	M	9 vjet 3 muaj 19 ditë	6794000	0	900000	0	0	5894000	Bëhet	
1064	8653	30.04.2008	Hiqmet	Shehu	Sali	Aishe	05.04.1928	Gjirokastrë	M	1 vit 10 muaj 10 ditë	1370000	100000	1024027	0	0	245973	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	8653	30.04.2008	Hiqmet	Shehu	Sali	Aishe	05.04.1928	Gjirokastrë	M	1 vit 10 muaj 10 ditë	1370000	100000	124027	0	0	1145973	Bëhet	
1246	10351	28.05.2008	Nadire	Sula	Mahmut	Sofije	05.04.1928	Peshkopi	F	1 vit	366000	240658	0	0	130000	0	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	10351	28.05.2008	Nadire	Sula	Mahmut	Sofije	05.04.1928	Peshkopi	F	1 vit	730000	240658	0	0	130000	359342	Bëhet	
374	2430	04.03.2008	Neim	Muhaj	Myrto	Bejashë	19.07.1939	Tepeleci	M	4 vjet 4 muaj 18 ditë	1602000	400000	426685	0	15000	760315	Ishte	VKM nr. 1699, datë 29.12.2008
	2430	04.03.2008	Neim	Muhaj	Myrto	Bejashë	19.07.1939	Tepeleci	M	4 vjet 4 muaj 18 ditë	3204000	400000	426685	0	15000	2362315	Bëhet	

BELGJIKË - Dhënia 6 orë liri për të "fortin" e Shkodrës nuk është pritur mirë nga mediat belge. Më 1 shkurt të këtij viti, Safet Bajri doli nga qelia për 6 orë, për t'i dhënë lamtumirën e fundit babait të tij. Por, sipas shtypit belg, kjo tregon edhe njëherë se sa i dobët është sistemi i drejtësisë në Shqipëri. "Shqiptari, i njohur edhe me pseudonimin Safet Rustemi dhe i



Safet Bajri

Mediat belge: Si përfitoi lirinë Safet Bajri, lidhja e tij me politikanët

lidhur me rreth dyzet vrasje, prostitucion dhe trafik droge u burgos në shtator të vitit të kaluar", shkruan 'Hln', duke komentuar këshu lejen prej 6 orësh që iu dha Safet Bajrit për të varrosur të atin. Madje, mediat belge shkojnë dhe më tej teksa vënë gishtin mbi lidhjet e

Safet Bajrit me politikanët shqiptarë, që sipas tyre i kanë siguruar këtë leje për të dalë nga burgu. Dhe sigurisht ngrenë pyetje se cila do të jetë hera tjetër që Safet Bajri do të marrë leje për të dalë nga qelia? Safet Bajri u vu në pranga në shtator të 2018-ës në zonën e "Xhamli-

likut" në kryeqytet. Ai dyshohet të jetë kreu i një grupi kriminal që kryente trafik droge, vrasje dhe trukum ndeshjesh. Rezultoni se Bajri është dënur edhe nga drejtësia belge për akuzën e shfrytëzimit të prostitucionit, dënim të cilin po e vuan në Shqipëri.

Policia gjen gjurmë gishtash në makinën me targa të huaja false të vjedhur në Kosovë

Vrasja e ish-policit Arben Bilali, gjenden maskat e armët e atentatorëve

TIRANË

Një javë pas ekzekutimit me kallashnik-ov të ish-efektivit të policisë, Arben Bilali, zbardhen detaje të reja. Sipas burimeve të TV "Klan", mësohet se personat që qëlluan nga makina e zezë e me targa të huaja mbi 50-vjeçarin në zonën e Selitës në kryeqytet kanë qenë të maskuar. Dy maskat e tyre dhe armët e krimit, dy automatikë të modifikuar ishin lënë në makinën që policia gjeti të braktisur në një kodër në Mjull Bathore. Në mjet janë gjetur shenja gishtash, që policia beson se janë të atentatorëve. Makina me targa të huaja false rezultoi të jetë vjedhur në Kosovë. Këto elemente - thonë për TV "Klan" burime pranë grupit hetimor - do të çojnë në zbulimin e atentatorëve të ish-efektivit të policisë. Pamjet filmike kanë ndihmuar deri tani vetëm në rindërtimin e ngjarjes. Të gjitha provat janë dërguar në laboratorin e Policisë Shkencore për ekzaminime të nevojshme dhe hetuesit po presin përgjigjen e të dhënave, përmes të cilave besohet se do të mund të zbardhet kjo ngjarje kriminale. Me to ekspertët priten



Ish-efektivi i policisë, Arben Bilali

të ndërtojnë profilin gjenetik të autorëve. Për zbardhjen e ngjarjes është ngritur një grup i posaçëm hetimor nga departamenti i policisë kriminale, ndërsa hetimet po drejtohen nga Prokuroria e Tiranës. Vrasja ndodhi mesditën e 30 janarit në një rrugicë pranë shkollës "At Zef Pllumi" në Selitë. Siç shihet nga filmimet, 50-vjeçari u

qëllua sapo zbriti nga një mjet, disa metra larg banesës së tij. Prokuroria ka dyshime se Bilali, të cilit i janë vrarë edhe dy vëllezër, të jetë ekzekutuar për motive hakmarrjeje. Kjo për shkak se familja Bilali ka pasur konflikte që prej vitit 1991 me një familje në Tiranë dhe përplasja mes tyre ka sjellë viktima nga të dyja palët.



Vendi ku ndodhi vrasja

VIKTIMA

Arben Bilali, i cili u ekzekutua dje ka qenë punonjës policie te komisarjati nr.2 si dhe efektivi i Repartit të Forcave të Ndërhjryes së Shpejtë (FNSh) në Tiranë, detyra nga të cilat është larguar disa vite më parë. 50-vjeçari është vëllai i tretë në familjen Bilali që ekzekutohet në atentat. Viktima e parë në këtë familje ishte Bujar Bilali, i cili u vra në një atentat në vitin 1997. Ndërsa, vëllai më i vogël, Leonard Bilali u ekzekutua më 10 gusht të vitit 2010.

Përgjimet e 'VOA'-s, Prokuroria e Krimeve të Rënda: Nuk ka hetim për gazetaren Klodiana Lala

TIRANË - Një ditë pasi "Zëri i Amerikës" publikoi përgjimet e prokurorisë për Avdylët dhe kryebashkiakun e Durrësit, Vangjush Dako, Prokuroria nisi hetimet për nxjerrje sekreti. Ndonëse nuk pati emra, u aludua edhe se gazetarja Klodiana Lala, e cila bashkëpunoi me BIRN për investigimin mund të ishte nën hetim. Por dje, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë ka njoftuar se po kryhen hetime për veprën penale "Zbulimi i akteve ose të dhënave sekrete", të parashikuar nga neni 295/a i Kodit Penal, të lidhur me publikimin në mediat elektronike dhe të shkruara të disa akteve procedurale të procedimit penal nr.339 viti 2016. Sipas Prokurorisë, hetimet në lidhje me këtë veprë penale kanë filluar që në muajin nëntor të vitit 2018 dhe lidhen me faktin se duke filluar që



Prokuroria e Krimeve të Rënda

nga viti 2017 dhe në vazhdim, në kundërshtim me ligjin janë bërë publike akte sekrete të përgjimeve të këtij procedimi penal. "Informojmë opinionin publik se gazetarja Klodiana Lala nuk është person nën hetim në këtë procedim penal dhe nuk është duke u hetuar nga ky organ procedues. Hetimet janë duke u kryer në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e personave të tjerë funksionarë të organ-

eve të drejtësisë, të cilët kanë hartuar akte të përgjimeve, kanë administruar këto akte dhe kanë pasur akses në to, por edhe kushdo tjetër që në bazë të ligjit është njohur me aktet e sipërcituara dhe ka pasur detyrimin ligjor për ruajtjen e sekretit hetimor si dhe marrjen e masave të nevojshme për ndalimin e publikimit të akteve të procedimit penal të mësipërm", deklaroi Prokuroria.

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BANKA E SHQIPERISE
DEPARTAMENTI I ADMINISTRIMIT
SEKTORI I PROKURIMIT

TENDER I HAPUR KOMBËTAR I SHOQUAR ME FTESA DIREKTE KANDIDATEVE TE HUAJ

Banka e Shqipërisë kërkon të realizojë objektin e prokurimit: "Shtypja e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

"Banka e Shqipërisë fton kandidatët e interesuar, të marrin pjesë në procedurën e prokurimit "Tender i hapur kombëtar i shoqëruar me ftesa direkte kandidatëve të huaj", për realizimin e objektit të prokurimit si më sipër, me fond limit 54,345,000 Lekë".

Dokumentet e tenderit mund të tërhiqen pranë Sektorit të Prokurimeve të Departamentit të Administrimit, të Bankës së Shqipërisë, me adresë: Rruga e Dibrës, Kompleksi "Halili", Kulla A, Tiranë, Tel. 042419411(ext. 1844), çdo ditë nga çdo person i autorizuar, me paraqitjen e një kërkesë me shkrim. Tërheqja e dokumenteve mund të bëhet vetëm pasi të keni bërë paraprakisht pagesën e paktyeshme prej 500 Lekë, pranë një banke tregtare në llogarinë e Bankës së Shqipërisë sipas detajeve të mëposhtme.

Përfutuesi: Banka e Shqipërisë
BIC: STANALTR
IBAN: AL68 1011 1008 0000 0000 2222 222L; BIC

Përshkrimi: Blerje dokumente tenderi për tenderin me objekt: "Shtypje e monedhave metalike përkujtimore për qëllime numizmatike '200 Lekë' dhe '100 Lekë', pa kurs ligjor, për nevojat e Bankës së Shqipërisë"

Oferta duhet të paraqitet në zyrën e Sektorit të Prokurimeve, pranë Departamentit të Administrimit, në Bankën e Shqipërisë, deri më datë 11 Mars 2019, ora 11:00, kohë në të cilën do të hapet edhe tenderi, ku ftohen të marrin pjesë kandidatët ose përfaqësuesit e autorizuar të tyre.

"Do të mbetet deri kur të na njohin si shtet"**Haradinaj: Nuk tërhiqemi nga taksa ndaj Serbisë e Bosnjës**

Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj në konferencë për media pas mbledhjes së qeverisë, është zotuar përsëri se vendimi për taksën ndaj Serbisë dhe Bosnjës e Hercegovinës nuk do të tërhiqet. Haradinaj duke folur për taksën, ka thënë se shteti serb po bënë shantazhe në mënyrë që taksa të hiqet, duke kërkuar vazhdimin e dialogut. Sipas tij, Kosova nuk duhet t'i pranojë shantazhet nga Beogradi, transmeton Telegrafi. "Kushtëzimi i dialogut është i papranueshëm, dialogu duhet të kthehet, dhe nuk humb veç Kosovës, nuk ndodhë dialogu. Taksa do të mbetet

RAMUSH HARADINAJ

Shefi i ekzekutivit kosovar duke komentuar deklaratat e kryetarit të Mitrovicës, Agim Bahtiri se nëse preken kufijtë e kësaj komune do të ketë luftë, ka thënë se deklaratat e tilla janë të ekzagjeruara. Haradinaj tha se për momentin nuk ka tendencë të destabilizimit, duke shtuar se të rrezikshme janë planet për tregti me territore.

deri në njohje, nuk kemi dilema. E keqja e kësaj është pranimi i shantazheve të Serbisë. Këta po bëjnë shantazh, dhe nuk duhet t'i pranojmë shantazhet e shtetit serb. Ne asnjëherë nuk e kemi kushtëzuar dialogun, as kur na janë tërheqë njo-

hjet. Beogradi nuk dëshiron dialog, mendoj që për këtë ata vendosin kushte", ka thënë kryeministri Haradinaj. Shefi i ekzekutivit kosovar duke komentuar deklaratat e kryetarit të Mitrovicës, Agim Bahtiri se nëse preken kufijtë e kësaj ko-

mune do të ketë luftë, ka thënë se deklaratat e tilla janë të ekzagjeruara. Haradinaj tha se për momentin nuk ka tendencë të destabilizimit, duke shtuar se të rrezikshme janë planet për tregti me territore. "Bahtiri si kryetar i Mitrovicës jep shpesh deklarata të tilla, dhe nuk është mirë që askush të ekzagjerojë me deklarata të tilla. Unë nuk shoh tendencë të destabilizimit, të vetmin rrezik janë planet për tregti me territore dhe kufij dhe ajo është rrezik", ka thënë kryeministri i vendit. Sipas Haradinajt, shija me të cilën do të përcaktohet mar-



Kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj

rëveshja finale, do ta përcjellë Kosovën përgjatë gjithë historisë. "Në koalicion jam me PDK-në, Nismën e AKR-në. Na ka lidhur kualiteti i zgjidhjes finale me Serbinë, mund të kemi ndonjë dallim në hapa apo etapa të caktuara, por të gjithëve na preokupon shija

e marrëveshjes. Unë kam vetëm një problem, çfarë shije do të ketë marrëveshja finale. Kushdo qoftë që e prishë shijen e marrëveshjes finale, le të shkojë kah të dojë. Nuk do t'i bashkohem askujt që e çon Kosovën drejt ndarjes", deklaroi Ramush Haradinaj.

Reagon politika kosovare: Miniera është çështje e brendshme**Trepça, Koçijançiq: Duhet të diskutohet në Bruksel***"Qëllimi ynë, t'i zgjidhim çështjet e hapura"*

Çështja e Trepçës duhet të zgjidhet me marrëveshje në Bruksel. Kështu ka reaguar zëdhënësja e Komisionit Evropian, Maja Koçijançiq, pas miratimit të Statutit të ri për minierën e lakmuar që ndodhet në Mitrovicë. Deklarata e saj ka shkaktuar reagim në Kosovë, ndërsa drejtuesit e saj janë shprehur kundër futjes së hundeve në çështjet e brendshme të shtetit të tyre. Deklarata e Koçijançiq u bë përmes agjencisë së lajmeve "Tanjug". "Bashkimi Evropian si ndërmjetësues i dialogut, ka për qëllim që të gjitha çështjet e hapura ndërmjet dy shteteve, t'i zgjidhë nëpërmjet një marrëveshje gjithëpërfshirëse për normalizimin e raporteve ndërmjet Beogradit dhe Prishtinës", ka thënë zëdhënësja e BE, e pyetur për pasojat që mund të ketë miratimi i Statutit për Trepçën që u votua para pak ditësh në parlamentin e dialogut dhe për fatin e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Ajo, gjithashtu, ka thënë se Bashkimi Evropian pret që Kosova të pezullojë vendimin për taksën, që do të mundësonte një kthim të shpejtë në dialogun e Brukselit. Ndërkohë edhe krerët e shtetit serb vazhdimisht e kanë theksuar se nuk do t'i kthehen dialogut derisa Prishtina nuk e zhbën vendimin për taksën. Ditë më parë janë organizuar edhe protesta në veri kundër vendimeve të Prishtinës për Trepçën, duke thënë se autoritetet kosovare po tentojnë ta gra-



Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Maja Koçijançiq

bisin Trepçën dhe të lënë serbët që jetojnë në veri të Mitrovicës pa punë. Siç shkruan "Novosti", Prishtina kishte refuzuar që në dialogun e Brukselit ta vinte në diskutim çështjen e Trepçës, pasi e konsideronte si pronë të Republikës së Kosovës, dhe për Kosovën një gjë e tillë ishte punë e kryer.

ISH-KRYEMINISTRI

Ish-kryeministri i Kosovës, Isa Mustafa shprehet se një kërkesë e tillë e BE për të diskutuar Trepçën në Bruksel është e papranueshme dhe absurde, ndër-

sa shton se duhet kundërshtuar fuqishëm dialogimi me Serbinë. "Më habiti kërkesa e BE-së që çështja e Trepçës të trajtohet në dialogun me Serbinë. Kosova në asnjë fazë nuk ka pranuar që për Trepçën dhe pasuritë e saj natyrore, të cilat janë në territorin e saj, të dialogojë me Serbinë. Është kjo një kërkesë absurde dhe e papranueshme, ashtu siç është e papranueshme që me Serbinë të dialogohet për kufijtë dhe për territorin e Kosovës. Në mandatin, kur unë isha Kryeministër

i vendit, përgatitëm dhe aprovuam Ligjin për Trepçën, duke e shpëtuar këtë simbol ekonomik të vendit nga falimentimi dhe privatizimi. Deputetët e LDK-së votuan para disa ditësh Statutin e Trepçës, i cili mori 2/3 e votave në Kuvend. Kjo flet për unitetin tonë karshi interesave jetike të vendit", sqaron Mustafa. Sipas tij duhet kundërshtuar fort që në emër të marrëveshjes gjithëpërfshirëse me Serbinë të dialogohen çështjet e sovranitetit dhe integritetit shtetëror.

KRYEMINISTRI

Kryeministri kosovar kritikoi përsëri qëndrimin e Maja Koçijançiq, e cila tha se Trepça është pjesë e dialogut. Haradinaj deklaroi edhe një herë se Bashkimi Evropian, nuk ka njohuri për gjendjen në shtetet e Ballkanit duke nënkuptuar se Trepça është çështje e brendshme e Kosovës e nuk ka pse të diskutohet me palën serbe.



Thaçi

PRESIDENTI NË SHBA

Presidenti i Kosovës Hashim Thaçi, i cili po zhvillon një vizitë zyrtare në SHBA, ka paralajmëruar se sot do të jetë pjesë e forumit në Këshillin për Marrëdhënie të Jashtme në Washington DC. "Pas pak do jem mysafir në njërin nga forumet më prestigjioze në SHBA, në Council on Foreign Relations në Washington DC, ku do të flas për angazhimin për të arritur marrëveshjen paqësore gjithëpërfshirëse, që do të sjellë njohjen e Kosovës nga Serbia dhe ulësen e shtetit tonë në Organizatën e Kombeve të Bashkuara", shkruan Thaçi në "Facebook".

VIP

Suplement
Pages

E mërkurë 6 shkurt 2019 GAZETA SHQIPTARE


"BULEVARDI POLITIK"

- Deputeti i PD-së, stërvitje në palestër një javë para protestës
- Merkel mbyll faqen e 'Facebook'-ut, mban hapur 'Instagram'-in
- Surpriza e partneres për kryeministren lesbike të Serbisë
- E shikon Sarkozyn në Venecia, gjesti që bën ish-presidenti francez

"E pi barin si burri yt?",
Kejsi çudit të gjithë me
reagimin ndaj ndjekësit



Nga Amarda Toska te Rovena Dilo, ja kush e gjeti dashurinë aty ku nuk ia priste mendja



Momentet e veçanta të
ditëlindjes së bashkëshortes
së Ardrit Gjebreas



VIP-at shqiptarë që njojnë dashurinë në punë

*Kush në kërcim e kush në këngë, ambientet
ku të famshmit gjetën gjysmën e tyre*

Nga Amarda Toska te Rovena Dilo, ja kush e gjeti dashurinë aty ku nuk ia priste mendja

VIP-at shqiptarë që njohën dashurinë në punë

Kush në kërcim e kush në këngë, ambientet ku të famshmit gjetën gjysmën e tyre


Pamela Aliaj

Shpeshherë e kërkojmë dashurinë kudo, por ndonjëherë nuk na i merr mendja që e kemi para syve dhe pikërisht e gjejmë në vendet ku më pak e mendojmë. Kjo gjë ka ndodhur dhe me VIP-at tanë, të cilët janë shumë të përfolur nga mediat, shpesh për marrëdhëniet e tyre e në raste të tjera për profesionet përkatëse. Por marrëdhëniet e tyre të kurorëzuara në dashuri në ambientet ku më pak iu merr mendja ka mjaftueshëm. Më poshtë po ju listoj disa prej tyre ku personazhet e famshme të mediave shqiptare, të cilët, përveç se janë në një lidhje, ndajnë edhe të njëjtin profesion.

ENI KOÇI DHE GENC PRELVUKAJ
Vetëm në fundvit të 2018, në një video që zbulonte pak nga prapaskenat e programit të Vitit të Ri "Op Labi Party", Genc Prelvukaj deklaroi se kishte pritur enkas këtë rast për të deklaruar lidhjen e shumëpërfolur me këngëtarën e njohur Eni Koçi. Dy këngëtarët jo vetëm që kanë pranuar lidhjen, por edhe kanë postuar të njëjtën foto nga festa e fundvitit, organizuar nga Labinot Gashi. Pak ditë më parë në të gjitha mediat rozë u përhap me shpejtësi një video nga prapaskenat e "Op Labi Party", në të cilën Genc Prelvukaj pranonte lidhjen me Eni Koçin. "Është e vërtetë. E kemi parë që në hyrje. Kemi zgjedhur një event si ky që të shfaqemi publikisht bashkë", - u shpreh Genci.




Vesa Luma dhe Big Basta



Ola Hasani dhe Egdalin Gorani



Salsano Rrapi dhe Erjona Kakeli



Eni Koçi dhe Genc Prelvukaj

ALBA HOXHA DHE ALBI NAKO

Na është paraqitur si një dashuri mjaft pasionante, ashtu si disiplinat e ndryshme të baletit që ata bëjnë. Klaudia Pepa dhe Albi Nako janë dashuruar në paskuintat e spektakleve të ndryshme dhe tashmë janë të martuar. Ndonëse prej disa kohësh ajo jeton në Itali, ku ka shkollën e saj të baletit dhe Nako vijon me jetën këtu. Megjithatë sërisht çifti duket më i dashuruar dhe i afërt se kurrë.

SALSANO RRAPI DHE ERJONA KAKELI

Salsano Rrapi ndan të njëjtin pasion për aktrim me bashkëshorten

e tij Erjona Kakeli. Dyshja janë bërë prindër të një vogëlusheje dhe janë shumë të lumtur me njëri-tjetrin.

ENADA HOXHA DHE GERD VASO

Nisur si një histori "rivalësh" në balet shumë pak mjaftoi për çiftin e balerinëve Enada Hoxha dhe Gerd Vaso, për t'u kthyer në një nga çiftet më të bukur të artit shqiptar. Ata kanë shumë vite të martuar së bashku dhe prej dashurisë së tyre ka ardhur në jetë edhe vogëlushi bukursh Roan.

AMARDA TOSKA DHE ERMAL MAMAQI

Ami dhe Ermali janë dy nga per-

sonazhet e njohur shqiptarë, të cilët dashurinë e tyre të lindur në skenën e spektaklit "Portokalli" e kanë kurorëzuar prej vitesh në martesë. Pas një sërë programesh të realizuara së bashku dhe biznesit të tyre, tashmë Ami dhe Ermali janë edhe prindër të vogëlushit Joel dhe vogëlushes Sia.

OLA HASANI DHE EZDALIN GORANI

Janë një nga çiftet e vjetra të baletit në vendin tonë, të cilët tashmë kanë vite që janë të martuar, pas njohjes së tyre në "Akademinë e Arteve". Ola dhe Egdalini kanë qenë të pandarë për shumë vite edhe në punën e tyre në Top Chan-

ALBAN SKËNDERAJ DHE MIRIAM CANI

Të dy këngëtarë, të dy mjaft të njohur dhe të dy shumë të dashuruar me njëri-tjetrin. Alban Skënderaj dhe Miriam Cani janë një nga çiftet më romantike të showbizit. Ata kanë sjellë në jetë vogëlushen e tyre Ameli.

ALBAN DUDUSHI DHE BIETA SULO

Çift në jetë, por edhe çift në profesion. Prej vitesh tashmë moderator i gazetari Alban Dudushi dhe Bieta Sulo punojnë së bashku në Top Channel. Tashmë për pak kohë ata do të bëhen prindër të një djali.

NORA ISTREFI DHE ROBERT BERISHA

Robert Berisha po ndjek gjurmët e bashkëshortes së tij për muzikë. Ai është bërë këngëtar dhe e shoqëron Norën kudo nëpër koncerte. Mos është kjo një strategji për të qëndruar afër saj?

VENERA DHE LIND ISLAMI

Venera Lumani dhe Lind Islami janë njohur gjatë kompeticionit "The Voice of Albania", ku Venera u shpall fituese. Tashmë ata jetojnë në Tiranë dhe vijnë të merren me muzikë, si dhe kanë realizuar bashkëpunime me njëri-tjetrin.

VESA LUMA DHE BIG BASTA

Edhe pse të dy janë muzikantë, nuk ishte muzika që i bashkoi çiftin e njohur Big Basta dhe Vesa Luma, por kërcimi! Ata u njohën më mirë me njëri-tjetrin gjatë pjesëmarrjes së tyre në spektaklin "Dancing with the Stars" ku dhe u dashuruan. Para pak kohësh çifti kurorëzoi në martesë dashurinë e tyre dhe tashmë janë prindër të vogëlushit Lian.



Nora Istrefi dhe Robert Berisha



Enada Hoxha dhe Gerd Vaso



Alban Skënderaj dhe Miriam Cani



Amarda Toska dhe Ermal Mamaqi



Alban Dudushi dhe Bieta Sulo




Alba Hoxha dhe Albi Nako

A ta janë një nga çiftet më të përfolura në mediat rozë. Blogerja Armina Mevlani dhe djali i ish-kryeministrit Berisha, Shkëlzen Berisha komentohen për çdo detaj nga jeta e tyre. Së fundmi, Armina ka dhënë një intervistë për revistën 'Elite' dhe ndër të tjera ka treguar variantin e vërtetë se



si është njohur me Shkëlzenin. 'Në fakt forma sesi jemi njohur ka qenë krejt rastësore. Jemi parë diku në një bar pa e njohur njëri -tjetrin për herë të parë dhe kemi pasur shumë tërheqje, madje sot e diskutojmë çfarë kemi ndierë në largësi atë ditë. Të dy jemi emocionuar dhe kemi pasur shumë interes për njëri-tjetrin. Unë pyeta një mikeshë kush mund të ishte, pasi as unë dhe as ajo nuk e dinim kush ishte. Më pas, pas disa kohësh, u gjendëm rastësisht me miq të përbashkët, në të njëjtën tavolinë dhe aty filloi gjithçka, aty bëra lidhjen e ditës së parë, kur u pamë nga larg. Nuk ishte lidhje e menjëhershme sigurisht, ndjenjëm shumë kohë thjeshtë duke komunikuar si fillim...Më pas u takuam dhe filloi gjithçka', rrëfeu Armina.



"Nuk e dija kush ishte...", Armina tregon për takimin e parë me Shkëlzenin

Ajo ka qenë gjithmonë e gatshme të komunikojë me ndjekësit e saj në 'Instagram' dhe sidomos pas arrestimit të Stresit. Partnerja e reperit të njohur këtë herë është pyetur nëse ajo konsumon hashash si bashkëshorti i saj Stresi. "Ti pin at barin njëjtë sikur burri jot apo jo?" Bukuroshja duket se nuk ka nguruar t'i përgjigjet kësaj pyetje: "Jo unë nuk kam prekur kurrë as bar as cigare, por në Kanada është legale bari dhe këtu i sheh të gjithë me të, kështu që burri im s'do duket si i vetmi se dhe në Shqipëri e pinë, thjesht s'e publikojnë", ka thënë ajo. Më herët ajo është shprehur se lirimi i Stresit nga burgu do të ndodhte shumë shpejt.



"E pi barin si burri yt?", Kejsi i çudit të gjithë me reagimin ndaj ndjekësit



Pas thashethemeve të bëra nëpër mediat rozë për lidhjen me Eni Koçin, producenti Genc Prelvukaj është shprehur në emisionin "Tour de Cool" rreth trajtimit që i kanë historisë së tij. Ai ka thënë se nuk ka patur probleme me pasqyrimin e lajmit, por me mënyrën sesi e kanë trajtuar lajmin disa portale, duke shprehur kështu indinjatën e tij. "Media këtë detyrë ka. Unë e kuptoj median. Jam i vetëdijshëm që në momentin që dal nga shtëpia jam njeri publik prej punës që unë bëj. Asnjëherë nuk kam marrë masa me kërcënime apo diçka tjetër, thjesht i kam vendosur në një listë ato medime të cilave nuk do t'iu hap telefonin", përfundon Genci në "Tour De Cool". Vetëm pak kohë më parë ai dhe këngëtarja Eni Koçi kanë pranuar publikisht se janë në një histori dashurie.

Lidhja me Eni Koçin, Genc Prelvukaj shpreh indinjatën për mediat



Ky është vërtet një muaj i bekuar për VIP-at tanë ku të shumtë janë festa që festojnë ditëlindjen. Vetëm para dy ditësh familja Gjebrea ka festuar ditëlindjen e Anilës, bashkëshortes së moderatorit Ardit Gjebrea. Përmes një darke familjare me miq dhe të afërm e, gjithashtu, me atmosferë nga muzikantë të njohur si Jualiana Pasha, Venera Lumani, Pirro Çako, Lind Islami etj është festuar një ditë e rëndësishme për familjen Gjebrea. Një urim mjaft prekës për Anilën ka ardhur nga djali i saj Joni, për të cilin ajo është shpirt i familjes. "Edhe 100 vite të tjera, o shpirti i familjes...", përfundon Joni në rrjetet sociale. Ndërkohë Arditi përmes një foto ku shfaqet Anila së bashku me vajzën e tyre Anna shkruan: "Gëzuar ditëlindjen fati im", përfundon moderatori i njohur. Në këtë darke speciale ka kënduar edhe Gjebrea vargjet e njohura të shkrimtarit të ndjerë Dritëro Agolli, "Kur të jesh mërzitur shumë".

"Ti je fati dhe shpirti i familjes..." momentet e veçanta të ditëlindjes së bashkëshortes së Ardit Gjebreas

BULEVARDI

Na merrni seriozisht!

Deputeti i PD-së, stërvitje në palestër një javë para protestës

Edhe pse shumë i angazhuar me protestën e banorëve të Astirit, deputeti i Partisë Demokratike gjen kohë edhe për pasionin e tij, që, siç duket është palestra. Për të parën herë deputeti i PD-së ka publikuar një foto nga palestra me shtanga në duar. Kjo foto e Balliut vjen rreth dhjetë ditë para se të fillojë protesta madhështore e 16 shkurtit, e organizuar nga opozita, ndërkohë që kreu i PD Lulzim Basha e ka cilësuar deputetin si simbolin e protestës.



Surpriza e partneres për kryeministren lesbike të Serbisë

Kryeministria e Serbisë Ana Brnabić është përfolur shumë në media për orientimin e saj seksual, pasi është femra e parë lesbike në krye të kësaj qeverie. Së fundmi mësohet se partnerja e 43-vjeçares Milica Djurić është shtatzënë. Revista serbe 'Gloria' ka mësuar se Djurić i është nënshtruar fekondimit artificial në Qendrën Klinike të Serbisë, Qendrës për Radiologjisë dhe MRI ku ajo ka punuar më parë. Gjithashtu, bëhet me dije se kjo është edhe arsyeja përse Brnabić nuk është shfaqur më në publik me partneren e saj. Ndërkohë ende nuk ka një reagim nga kryeministria serbe, e cila nuk ka dëshiruar të flase publikisht për jetën private.

Merkel mbyll faqen e 'Facebook'-ut, mban hapur 'Instagram'-in

Liamturimë Facebook! Edhe një personalitet tjetër nga politika gjermane li kthen kurrizin 'Facebook'-ut. Është pikërisht Kancelarja Angela Merkel, e cila preferon Beatles-at dhe ëndërron të udhëtojë me tren nëpër Siberi, që së fundmi ka mbyllur faqen e saj në rrjetin social. Mbyllja e 'Facebook'-ut erdhi përmes një videoje të postuar në median sociale. Aty Angela Merkel deklaroi, se "ju e dini, që nuk jam më kryetare e partisë CDU, dhe prandaj do ta mbyll faqen time të 'Facebook'-ut. Në dhjetor Merkelin e zëvendësoi Sekretarja e Përgjithshme, Annegret Kramp-Karrenbauer. Në të njëjtën kohë Merkel falënderoi ndjekësit e saj në 'Facebook' për "mbështetjen e madhe". Megjithatë ju mund të vazhdoni ta ndjekin punën time si kancelare, tha Merkel. Për këtë është përgjegjëse faqja e qeverisë gjermane në Facebook. Mbështetësit mund të më ndjekin edhe në Instagram, u shpreh Kancelarja. Më shumë se 2,5 milionë vetë e kishin klikuar me "pëlqim" faqen e Kancelares Merkel, që kishte lënë kështu pas presidentin Macron, i cili ka vetëm 2,3 milionë ndjekës në Facebook, apo kryeministren Theresa May me 503.000 ndjekës.



E shikon Sarkozyn në Venecia, gjesti që bën ish-presidenti francez

Ish-konkurenti i 'Big Brother', Toros Shahinaj dhe mamaja e tij duke ecur nëpër Venecia, befasisht kanë parë ish Presidentin francez Nikolas Sarkozy me partneren e tij Carla Bruni. "A është ky Sarkozy", u ka thënë e ëma e Torosit, rojeve të Sigurisë të ish-çiftit Presidential. Por, pa pritje përgjigjen e tyre, Sarkozy, është kthyer nga zonja e vjetër në moshë dhe i ka thënë i buzëqeshur. "Po unë jam". Ish-çifti Presidential ka ftuar gruan në një shëtitje të shkurtër nëpër Venecia e më pas ka patur mirësinë ta ftojë për një kafe në hotelin ku po qëndronin. Kafes i është bashkuar edhe Torosi, i cili ka mbetur i impresionuar nga thjeshtësia e Sarkozy dhe një prej femrave më të bukura në planet, Carla Brunin.



Këshilla

Shumica prej nesh dëshirojmë të kujdesemi mirë për veten tonë dhe ne e dimë se rutinat e mira dhe parandalueset e vetëkujdesit janë mënyra më e mirë për ta bërë këtë. Por mund të jetë, gjithashtu, dërmuese, stressuese, dhe kërkon kohë për të kujtuar të gjitha gjërat që duhet të bëjmë. A keni pirë ujë të mjaftueshëm? A keni marrë një minutë për të medituar? A nuk duhet të ngrihesh dhe të ecësh? Kur hera herën e fundit që keni ngrënë? Apo flini tetë orë? Sa kohë keni qenë ulur në tryezën tuaj? Duke ditur se nuk keni bërë asnjë nga këto veprime të vetëkujdesit, mund të ndiheni jashhtëzakonisht të stresuar - pikërisht e kundërta e efektit që vetëkujdesi duhet të transmetojë. Gjëja e fundit që iu duhet është stresoni edhe se si të kujdeseni për veten. Por kur ju keni një orar të zënë, është e vështirë të qëndroni të përgjegjshëm qoftë edhe për veten tuaj, dhe kështu është e lehtë të lini mirëqenien tuaj dhe shëndetin - të rrëshqas. Dhe kjo është kur problemet shëndetësore - të shkaktuara nga stresi, zakonet e dobëta të të ngrënit, mungesa e stërvitjes ose diçka tjetër - mund të zhvillohen. Për fat të mirë, ka shumë truke atje për t'iu ndihmuar të kujdeseni për veten. Ata ndihmojnë të largoni stresin duke ju ndihmuar të ndërtoni një rutinë të shëndoshë të vetëkujdesit dhe duke e bërë atë një zakon që është më i lehtë të mbahet tutje. Këtu janë vetëm disa ide dhe aplikacione që mund të ndihmojnë automatikisht që vetëkujdesi të bëhet prioritet, pavarësisht nëse keni dy minuta ose dy orë kohë:

1. Mos bëni asgjë për dy minuta
2. Dëgjoni tinguj të valëve të detit apo pikave të shlut në aplikacione të ndryshme
3. Ngrihuni dhe bëni një shëtitje jashtë.
4. Qëndroni të hidratuar me aplikacione si iDrated, Waterlogged dhe Eight Glasses A Day
5. Harroni të merrni drekë? Temple dhe Time4Lunch mund të ndihmojnë me këtë.
5. Sfidoni veten për të bërë drekën tuaj në mbrëmje.
7. Ndiqni ciklin tuaj të gjumit me vegla të palestrës si FitBit ose Jawbone ose aplikacionin për telefon Sleepbot.
8. Proveni Bedtime Function të iPhone për të dikur kur të zgjoheni dhe kur të shkoni të flini.
9. Programoni disa momente "mos e shqetësoni" në mënyrë që të mund të përqendroheni te vetja pa shqetësim
10. Shikoni disa foto dhe video të kafshëve të lezetshme
11. Vizitoni një strehimore të kafshëve.



Nuk kujtoheni të kujdeseni për veten? 20 këshilla për ta bërë atë rutinë



12. Shikoni video mësimore dhe motivuese.
13. Mbani ditari çdo ditë me aplikacione si DayOne
14. Mbani gjurmët e asaj që ju shqetëson me aplikacione si Worry Watch.
15. Vizitoni mjekun tuaj

dhe kontrolloni katër numrat tuaj shëndetësor - presionin e gjakut, kolesterolin, sheqerin në gjak dhe indeksit të masës së trupit (BMI).
16. Lëshoni e mendimet e këqija ose ndërhyrëse me lojëra si Good Blocks.

17. Meditoni për pesë minuta - edhe kjo është e mjaftueshme për të ndihmuar në largimin e stresit
18. Praktikoni joga në zyre nëse nuk keni kohë të largoheni nga tavolina juaj.
19. Bëni punë vullnetare.

20. Bëni një listë të zakteve.
Natyrshisht, vetë-kujdesi është vetë nga natyra personal - kështu që asnjë gjë nuk do të funksionojë për të gjithë. Gjëja e rëndësishme është të kuptoni se çfarë hapa proak-

tiv ju doni të bëni për të marrë një trajtim më të mirë për shëndetin dhe mirëqenien tuaj. Dhe, pasi ta keni bërë këtë, lajmi i mirë është se ka shumë aplikacione, faqe interneti dhe truke për të filluar.

DOKUMENTET

GOFFREDO PARISE

1969, italianiani që vlerësonte Shqipërinë komuniste në "Corriere della Sera"

Ylli Polovina

Radiogramet mes diplomatit dhe Ministrisë së Jashtme për gazetarin italian dhe vizitën e tij më 1969

Titulli që "Miq të heshtur të Kinës" edhe pse qeveria komuniste e cilësonte edepsëz

Epërditshmja italiane me titullin kopje ditore, "Corriere della Sera", në 31 korrik 1969 botoi një intervistë me gazetarin, shkrimtarin dhe njëkohësisht bashkëpunëtorin e saj, Goffredo Parise. Titulli që "Miq të heshtur të Kinës". Në intervistë Goffredo ishte marrë prej njërit nga gazetaret më të njohur të "Corriere della Sera", autor edhe i mjaft librave të mirë: Xhuliano Xinkones (Giuliano Zincone).

Në rreshtat e parë të hyrjes për paraqitjen e bisedës redaksia shkruante se "Para pak ditësh Goffredo Parise u kthye nga Shqipëria, ku kish shkruar me ftesën zyrtare të qeverisë shqiptare nëpërmjet ambasadës së Shqipërisë në Itali dhe Shoqatës Itali-Shqiptare.

I kemi bërë bashkëpunëtorit tonë një sërë pyetjesh lidhur me gjendjen politike, psikologjike e kulturore të këtij vendi që përfaqëson pikën më të avancuar të influencës maoiste në Evropë".


Pyetja e parë e kësaj interviste, nga më të rrallat dhe spektakolaret e botuara në shtypin italian gjatë gjysmëshekullit realkomunist shqiptar, lëndë e shkruar që zuri hapësirën e një faqeje të tërë të "Corriere della Sera", ishte kjo: "Ç'është Shqipëria?"

Përgjigja e Goffredo Parise u formula me fjalët: "Një enciklopedist fenomenolog, jo pa humor, e ka përcaktuar Shqipërinë kështu: Një vend prej afro 2 milionë banorësh, sipas formulës së re (New Formula). Një enciklopedist politik aktualist dhe snob, do ta përcaktonte: vend i vogël marksist-leninist që shumë pak e njohin, i mbrojtur nga Kina dhe, për të cilin ka filluar të flitet".

Në vijim pjesa tjetër e përgjigjes së Goffredo Parise për pyetjen e parë ishte kjo: "Vulgarët e përcaktojnë si një vend delesh. Personalisht, duke qenë i detyruar ta përshkruaj me pak fjalë, do të thosha: vend gjeografikisht shumë i ngjashëm me disa krahina të Italisë (Friuli, Karnia, Pulia), me banorë që kanë karakteristika somatike dhe temperamentale shumë të afërta me fshatarët dhe malësorët e këtyre krahinave, të shënuar në këtyre nga një ndjenjë shumë e fortë (patriotizmi) dhe nga një detyrë shumë e rreptë (puna); vend që mbahet me dorë të fortë dhe nganjëherë të hekur, nga një ideologji (marksiste-leniniste), por në radhë të parë nga njerëz politikisht shumë të aftë në realizimin dhe zhvillimin e kësaj ndjenje nacionale dhe të kësaj detyre produktive".



Faksimile të radiogramave mes diplomatit shqiptar në Romë dhe Ministrisë së Jashtme në Shqipëri



Më tej: "Në qoftë se kohët e fundit ne e shohim Shqipërinë të paraqitet në një farë mënyre para Evropës, kjo nuk i detyrohet vetëm, sikundër mund të besonte politikani aktualist, snob, mbrojtjes që i bën Kina, por faktit se pas 25 vjetëve punë politike, bujqësore e kulturore shumë të rëndë, ajo (Shqipëria) është, me gjithë varferinë, e pjekur për t'u paraqitur: sepse u ka mësuar shkrim dhe këndim banorëve të saj të rinj, analfabetë në më shumë se 80 përqind para përfundimit të luftës; sepse u ka mësuar tyre të bonifikojnë kënetat, gjatë gjithë bregdetit të kultivojnë tarraçat, që nga baza deri në majë të maleve të zhveshura, duke treguar se për të ngrënë duhet jo vetëm prodhim, por edhe shfrytëzim i çdo rripi toke buke; sepse ka mësuar përveç këtyre, se një vend i vogël duhet të dyshojë gjithnjë tek fqinjët e mëdhenj dhe të ketë besim nga shumë të mëdhenjtë që janë larg; dhe u ka mësuar më në fund se, duke ndjekur këtë politikë të papërkulshme fshatare, mund të arrihen rezultate që nuk merren me mend, ashtu si për shembull lindra e industrive siderurgjike, mekanike, tekstile dhe kimike, me dimensione të konsiderueshme, në krahasim me nevojën e brendshme dhe, sidomos të tilla që i lejojnë vendit të bëjë hapat e para drejt Evropës si një shtet që dalëngadalë në rrugën që do ta bëjë atë modern, dhe jo një vend bagëtish".

KËRKOI TAKIM ME NJË TË BURGOSUR POLITIK
Do t'i rikthehemi përgjigjeve që Goffredo Parise i dha Xhuliano Xinkones, por lexuesi me siguri e

ka një kërshe: si ja dolën stalinistët në Shqipëri në pushtet në Tiranë dhe trupa diplomatike e saj në Romë, këtij aksioni mediatik për imazh pozitiv të vetvetes, duke shënuar realisht një kulm, çfarë atëkohë që gjë tepër e rrallë, sepse bota demokratike nuk mund t'i kryente shërbime bojatisjeje një regjimi me shkelje të rënda e të përsëritura të drejtave të njeriut.

Deri në vitin 1969 një aksioni të tillë të suksesshëm ia kishte dalë vetëm ambasada shqiptare në Paris me "Le Monde". Në këtë të përditshme të fundit, edhe pse pati ndikuar i fuqishmi i redaksisë së saj, Robert Escarpit, një intelektual, shkrimtar dhe dijetar me përmasa shumë më të famshme se Goffredo, aksioni i depërtimit dhe i botimit kishte zgjatuar disa muaj.

I Romës ndodhi brenda më pak se gjashtëdhjetë ditësh, pothuaj

me shpejtësinë e një blici. Për stilin burokratik dhe dogmatik të Tiranës zyrtare kjo që e papërfytyrueshme, pothuaj një habi.

Fillimi i kësaj historie të pazakontshme suksesi mediatik ka të pleksur me rol të spikatur dy persona: Ksenofon Nushin, ambasadorin shqiptar në Romë, realisht një nga më të shquarit diplomat të regjimit komunist, si edhe Fosko Dinuçin (Fosco Dinuci), të shumëdashurin nga Enver Hoxha, të cituarin e shpesh të prej tij, kryetar i Partisë Marksiste-Leniste Italiane.

E realizuar me një intervistë në 31 korrik 1969 kjo ngjarje filloi në 4 qershor të atij viti, kur ambasadorin Nushi i nisi Ministrisë së Jashtme në Tiranë, radiogramin nr. 689. Me të e vinte në dijeni organin e saj epror se në 1 qershor kishte biseduar me gazetarin dhe shkrimtarin, po ashtu edhe mikun e Partisë Marksiste-Leniniste Italiane, Goffredo Parise. Tema e saj pati qenë një kërkesë e shprehur prej italianit: dëshiron të bënte një vizitë në Shqipëri. Në prill ai kishte vizituar Kinën dhe Hanoin, duke shkruar dhe botuar pas kësaj një reportazh të gjatë pozitiv për këto dy vende komuniste. Nisur nga kjo, por edhe prej faktit që për Goffredo Parise diplomatët kinezë në Romë i kishin folur shumë mirë Ksenofon Nushit, ky propozonte që t'i jepej mundësia edhe për të ardhur në Shqipëri. Kohë të përshatshme për këtë ambasadori shihte fundin e po atij muaji: qershorit.

Duke vërtetë shumë shpejt, por Nushi nuk donte asnjë vonëse, me siguri nga që e dinte se në Minis-

trinë e Jashtme qenë të predispozuar për t'i zvarritur nisura të tilla, të cilat nuk kishin asnjë siguri si do të përfundonin. Niseshin për imazh të mirë dhe pasonin të kundërtën: vetënxirjen.

Sipas radiogramit 706 të nisur prej Ksenofon Nushit në 9 qershor Tiranë vihej në dijeni se ambasadori e kish ftuar Goffredon për darkë dhe gjatë saj patën biseduar për hollësi të tilla, siç ishte edhe qëndrimi i ftohtë që mbante gazetari ndaj Moskës zyrtare. Kjo garantonte se ai nuk ishte prosovjentik.

Pesë ditë më vonë, në 14 qershor 1969, një informacion i kryetarit të Komitetit për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme, Misto Treska, i firmosur prej një zëvendësi të tij, i komunikonte instancës eprorë, ministrit të Jashtëm, se ambasada në Romë propozonte ardhjen në Shqipëri të gazetarit shkrimtar Goffredo Parise dhe se për këtë vetë Komiteti që dakord. Italiani dashamirës dhe mik i marksist-leninistit Fosko Dinuçi do të vinte dhe ishte me shpenzimet e tij, porse për qëndrimin në Tiranë dhe në çdo qytet tjetër; të cilin do ta vizitonin, do të paguante shteti shqiptar. Për një dëshirë të tij që të merrte me vete edhe të shoqen, patën bërë sikur nuk kishin dëgjuar.

Me penë bojëkuqe në anë të këtij informacioni të 14 qershorit bëhej shënimi se qenë dakord me çfarë propozonte ambasada dhe Komiteti për Marrëdhënie Kulturore e Miqësore me Botën e Jashtme. Shënimi shkronjëkuqe porositte marrjen e masave të nevojshme për pritjen dhe sho-

“
"Corriere della Sera", 31 korrik 1969: Pse Shqipëria është avantpost i Maoizmit në Evropë, por Hoxhizmi ka edhe disa ndryshime

Opinion

Sportiv

Kur taksat shndërrohen në vjedhje nga ana e shtetit

Nga Adri Nurellari

(vijon nga faqja 1)

... të Shqipërisë. Bëhet fjalë për skajin verilindor të Shqipërisë ku bashkohen kufijtë e Shqipërisë, Kosovës dhe Malit të Zi me një potencial të jashtëzakonshëm për turizëm malor e madje edhe për skijim, por që ende neglizhohet e lihet pa shfrytëzuar. Çdo lexuesi ia rekomandoj fort që ta eksplorojë atë zonë marramendëse, por nuk është ky thelbi i artikullit. Një ndër gjërat e para që të bie në sy e ta këput shpirtin është mungesa totale e infrastrukturës. Rrugët janë ato që i ka pas lënë ushtria popullore e RPSSH dikur e vendosur në masë për të mbrojtur kufijtë, por tani janë të mbushura me baltë e janë të kapërcyeshme vetëm me makina të larta 4x4. Kur mbërrin tek stanet e Dobërdollit shihet se nuk ka as rrymë, as sinjal telefonik as sinjal televiziv, por kishte taksa. Vetëm mobitel malazez kapte. Pra, shteti nuk iu jepte asnjë gjë atyre banorëve të atjeshëm, të cilët mezi mbanin bagëtinë e tyre dhe mezi kishin organizuar disa bujtina rudimentare për turistë të apasionuar pas maleve, por ndërkohë iu merrte taksa. Jepnin taksa në këmbim të asgjëje. Kontratë sociale është kur shteti jep diçka në këmbim të asaj që merr mirëpo kur nuk kthen asgjë atëherë kjo situatë nuk mund të quhet tjetër përveçse vjedhje nga ana e shtetit.

Ajo situatë absurde me kujtoi një thënie të famshme të Benjamin Franklin, i cili thoshte se: "Në këtë botë asgjë nuk mund të thuhet të është e sigurt, përveç vdekjes dhe taksave". Pra, rasti i Dobërdollit tregon se ka taksa por s'ka shtet ose më saktë shteti nuk jep ndonjë gjë për taksat që merr. Fatkeqësisht askush nuk e analizoi siç duhet se çfarë jep shteti për qytetarët në këmbim të taksave që ata japin. Madje në opinionin publik ka pak debat se si shpenzohet paratë e taksapaguesve politikë, të cilët nuk e kanë për gjë që të bëjnë bamirësi e japin shpërblime me paratë e buxhetit sikur të ishin paratë e trashëguara prej babait të tyre. Shpenzimet buxhetore nuk i trajtojnë si borxh që ata ia kanë qytetarëve por i shesin investimet si favor për të cilat ata duhet të shpërblehen e kompensohen duke dhënë votën. Tek ne taksat rriten gradualisht pa kuptuar, rregullat e lojës ndërshohen e improvizohen shpesh çdo vit. Në shumicën e rasteve këto ndërshime nuk bëhen për të rritur ekonominë e vendit dhe mirëqenien e qytetarëve por për të favorizuar aktorë të caktuar ekonomikë apo segmente të posaçmë elektorale. Mirëpo ndërkohë që taksat rriten,



nuk rritet cilësia e shërbimeve publike si drejtësia, arsimit, shëndetësia që shteti i jep qytetarëve. Për mos të folur që investimet infrastrukturorë janë pothuaj inekzistente vite të fundit.

Për të krijuar një ide se sa e rëndë është barra e taksave në Shqipëri mjafton të shikohet renditja që ka në raportin Paying Taxes të IFC-së dhe Pricewatercooper dhe të krahasohet me vendet e tjera fqinje. Ky raport i rendit vendet në varësi të lehtësisë së pagesës së taksave, numrit të taksave dhe vëllimit të tyre. Shqipëria del dukshëm më keq se fqinjët e saj duke mbajtur vendin 122-të. Ndërkohë Kosova është në vendin 44, Serbia 79, Mali i zi 68 dhe Maqedonia 31. Për të kuptuar se sa e madhe është ndërhyrja dhe përmasa e shtetit shqiptar në ekonomi duhet parë raportin i përvitshëm "Doing Business". Ky raport i nxjerrë prej Bankës Botërore për klimën e biznesit e nxjerr Shqipërinë në pozicionin më të keq në rajon. Sivjet Shqipëria renditet në vendin e 63-të ndërkohë që Kosova 44, Mali i zi 50, Serbia 48 dhe Maqedonia 10. Po ashtu në raportin e lirisë ekonomike të botuar nga fondacioni prestigjioz amerikan Heritage, ekonomia e Shqipërisë konsiderohet si pjesërisht e lirë duke u renditur në vendin e 65-të. Pra, ndërhyrja e shtetit në ekonomi është

e madhe, qytetarët paguajnë shumë taksa, mirëpo marrim shumë pak në këmbim të asaj që paguajnë.

Për të kuptuar më saktë marrëdhënien mes popullit dhe taksave duhet analizuar struktura e të ardhurave buxhetore në Shqipëri duke shqyrtuar buxhetin e vitit 2019. Taksa që mendohet se do të sjell më shumë të ardhura në buxhet në Shqipëri është Tatimi mbi Vlerën e Shtuar (TVSH) që në buxhetin e vitit 2019 pritet të sjellë më shumë se një të tretën 31.5% e të ardhurave totale buxhetore. Akciza për naftë, alkool etj. pritet të sjellë në total 9.9% të të ardhurave, duke bërë që së bashku me TVSH-në këto taksa të konsumit do të të përbëjnë mbi 41% të parave të planifikuara për t'u mbledhur vitin e ardhshëm. Tatimitimi që pritet të merret këtë vit nga bizneset parashikohet se do të sjellë diku tek 7% të të ardhurave të shtetit ndërsa tatimi mbi të ardhurat personale do të përbëjnë diku tek 8.5% të totalit. Pra, të ardhurat që vijnë nga suksesi i shoqërisë pra fitimet apo të ardhurat personale, përbën një copëz të vogël të të ardhurave në Shqipëri. Pjesa tjetër e buxhetit përbëhet nga të ardhurat prej pushtetit vendor, të ardhurat nga fondet speciale (ku spikasin sigurimet shoqërore) që do të sjellin që pritet të

sjellin 20% të totalit si dhe të ardhurat jo-tatimore me rreth 7.4%.

Fakti që shteti i siguron të ardhurat e veta dërrmuese në mënyrë indirekte nëpërmjet taksimit të konsumit shkakton dy probleme kryesore. Së pari, buxheti i shtetit dhe për rrjedhojë edhe shpenzimet që bëjnë nuk varen prej suksesit të shoqërisë, sepse diku tek 15.5% e të ardhurave buxhetore vijnë nga tatimitimi i sipërmarrësve dhe nga tatimi mbi të ardhurat personale. Kjo do të thotë që qeveritarët janë indiferentë e mosk-okëçarës për mbarrëvajtjen e biznesmenëve apo të ardhurat e qytetarëve, sepse këto elemente ndikojnë fare pak në mbushjen e thesit të buxhetit të shtetit ku e fusin dorën në mënyrë të shkujdesur për ta harxhuar.

Së dyti, fakti që qytetarët e thjeshtë apo biznesmenët paguajnë vetëm një pjesë të vogël të buxhetit në mënyrë të drejtëpërdrejtë, i bën ata të ndihen më pak pronarë të buxhetit shtetëror. Pra, në kushtet kur nuk i shikojnë dhe nuk e kuptojnë se paratë shteti është duke ia marrë në mënyrë indirekte, ata edhe kërkojnë më pak llogari ndaj qeveritarëve. Kjo është arsyeja kryesore përse qeveritarët flasin për investime apo shpenzime buxhetore si të ishin paratë e tyre dhe kërkojnë që qytetarët e marrin të këmbim të taksave tona.

heti prej të ardhurave të tyre si individë apo sipërmarrës, ata nuk ndihen se kanë të drejtë të kërkojnë llogari për mënyrën se si shpenzohet buxheti dhe ndihen madje mirënjohës nëse kanë ndonjë përfitim minimal prej shpenzimeve buxhetore.

Nuk është aspak rastësi që banorët e Kukësit bëjnë një protestë të dhunshme kundër tarifës së kalimit të autostradës së kombit vetëm atëherë kur e panë në mënyrë të prekshme e materiale se do të nxirrin 5 euro nga xhepi. Mirëpo ndërkaq për vite me radhë kanë paguar shumë më shumë se aq në mënyrë indirekte nëpërmjet 20 centëve të paguara për çdo litër si taksë qarkullimi. Faturën për përdorimin e rrugës ishin tashmë duke e paguar prej kohësh në mënyrë masive në formën e një çmimi të kripur prej taksës për qarkullimin, por nuk e kuptonin dhe prandaj nuk u revoltuan asnjëherë. Vetëm kur u desh ta nxirrin drejtëpërdrejtë nga xhepi e t'ia jepnin në dorë punonjësit të traut atëherë u vetëdijësuan për padrejtësinë dhe taksimin e tepruar. Po ashtu duhet theksuar se nafta në Shqipëri është më e shtrenjtë në rajon, sepse përveç koston me të cilën importohet ngarkohet me 37 lekë për litër për akcizën, 27 lekë për litër si taksë qarkullimi; 3 lekë për litër si taksë karboni, 1 lekë për litër si tarifa e markimit dhe ajo e skanimit, ndërsa TVSH totale arrin në 28 lekë për litër. Po ashtu studentët u revoltuan e dolën në protestë prej tarifimit të provimeve të mbartura që iu rënduan xhepin, por nuk e kanë vranë mendjen dhe s'kanë treguar kurrfarë ndjeshmërie për taksat indirekte që janë shtuar gradualisht dhe i kanë rënduar në formë të fshehur prej vitesh.

E gjithë kjo situatë na lë të kuptojmë se kemi nevojë që të rishqyrtojmë marrëdhënien me shtetin, sepse kemi një publik ende të pasqaruar e pandërgjegjësuar. Kjo do të thotë se kemi nevojë për një fushatë të mirëfilltë mbarekombëtare të edukimit për ekonominë e tregut dhe botën financiare. Kemi nevojë për më shumë vëmendje e vigjilencë për administrimin e taksave tona të drejtëpërdrejtë dhe indirekte dhe për presion më të madh që ato të trajtohen me përgjegjshmëri e transparencë prej qeveritarëve. Kemi nevojë që t'i japim më shumë hapësirë temave ekonomike në debatin tonë publik dhe ta përqendrojmë më shumë vëmendjen tek mënyra se si hartohet buxheti i shteti, se si planifikohen shpenzimet buxhetore dhe ajo që është më e rëndësishme tek ajo që marrim në këmbim të taksave tona.



Sulmuesi pret zgjidhjen e situatës

Sebino Plaku: Kam besim te presidenti Qarri

Te Kamza ka shpresë dhe kjo vjen edhe nga goja e atyre lojtarëve, të cilët kanë më shumë eksperiencë dhe në ekipin kryeqytetas kanë rolin e liderit. Një prej tyre është edhe sulmuesi Sebino Plaku, i cili ka bërë edhe zv.

trajnerin. Plaku, në një prononcim që ka dhënë për "Supersport" lidhur me situatën në të cilën ndodhet skuadra, ka pohuar: "Vetë situata është e ngarkuar. Është në vazhdimësi dhe ngjarjeve. Kemi pretenduar që kemi bashkëpunim

me bashkinë dhe presidentin Qarri. Kemi dëgjuar që kryetari i bashkisë nuk dëshiron të bashkëpunojë. Kjo situatë u reflektua edhe në ndeshjen me Partizanin", - tha sulmuesi fillimisht. Lidhur me objektivin që tashmë ka Kamza dhe

është mbijetesa mes më të mirëve të futbollit shqiptar. Sebino Plaku ka pohuar: "Unë jam kapiten dhe në shumë raste duhet të bëj edhe ndërmjetësin. Kemi marrë një premtim nga presidenti Qarri. Do të vazhdojmë dhe do të harrojmë gjithçka, të japim maksimumin. Një gol në fushën kundërshtarë mund të na ndihmojë që të kualifikohemi", - ka pohuar Plaku, një nga kualitetet e skuadrës së Kamzës dhe Superiores.



Jeton Selimi

Sjellje e gabuar e tifozëve, vlonjatët dënohen me 1 mln lekë gjobë. 2 mln për bardheblutë

Disiplina "përkëdhel" Kastriotin, gjoba për Flamurtarin dhe Tiranën

Krutanët dënohen dy ndeshje në fushë asnjane

Komisioni i Disiplinës në Federatën Shqiptare të Futbollit ka dhënë verdiktet për javën futbollistike që lamë pas, ndërsa për vendimet e tij ka pasur shumë interes, sidomos pas akuzave të klubit të Skënderbeut, sipas të cilit lojtarët e tij janë dhunuar përpara sfidës ndaj Kastriotit. Kështu, 'Disiplina', pasi ka shqyrtuar relacionet e zyrtarëve të ndeshjes, e ka dënuar Kastriotin me zhvillimin e dy takimeve në fushë asnjane dhe me një gjobë prej 50 mijë lekësh të reja. Krejt ndryshe nga çka priste Skënderbeu, me drejtuesit korçarë që minimalisht kërkonin fitoren në tavolinë dhe që mund ta apelojnë këtë vendim të 'Disiplinës'. Po ashtu, 'Disiplina' ka gjobitur Flamurtarin dhe Tiranën për sjellje të gabuar të tifozërve, por sikundër në rastin e ndeshjes Kukësi-Laçi, ku u anashkalua goditja e gjyqtarit anësor, edhe për ndeshjen Flamurtari-Kukësi, 'Disiplina' ka mbajtur të njëjtin standard, duke konfirmuar se vijon të mos respektojë nenet e Kodit Sportiv.

JA VENDIMET E KOMISIONIT TË DISIPLINËS:

1. KF "Tirana", për sjellje të



gabuar të spektatorëve duke hedhur sende brenda rrethimit të fushës, në bazë të Nenit 66/1 të KDS, dënohet me gjobë në masën 200.000 (dyqind mijë) lekë.

2. KS "Kastrioti", për dëshitim në përmbushjen e përgjegjësiave për organizimin e ndeshjes kundër KF Skënderbeut, duke mos garantuar sigurinë e lojtarëve kundërshtarë si dhe sjellje të gabuar të spektatorëve, në bazë të nenit 5/2; 64/c; 65/2 dhe 66/1 të KDS, dënohet me zhvillimin e 2 (dy) ndeshjeve në fushë asnjane dhe gjobë në masën 50.000 (pesëdhjetë mijë) lekë. Për vlerësimin e kriterit infrastrukturor, çështja t'i referohet Komisionit të Licencimit.

3. Zyrtari i KS "Kastrioti", Gazmet Vogli, për sjellje të gabuar ndaj zyrtarëve të ndeshjes duke përdorur fjalë

fyese, në bazë të Nenit 49/2/a) të KDS dënohet me 8 (tetë) ndeshje pezullim nga aktivitetet futbollistike. Në bazë të nenit 20 të KDS, zyrtarit i ndalohet qëndrimin në dhomat e zhveshjes, stoli i rezervave dhe territori përreth fushës.

4. FC "Flamurtari", për sjellje të gabuar të spektatorëve, në bazë të Nenit 66/1 të KDS, dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lekë.

5. Zyrtari i KF "Egnatia", Agron Alia, për protestë ndaj vendimeve të zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 56/1/a) të KDS, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga aktiviteti.

6. KF "Bylis", për sjellje të gabuar të spektatorëve, në bazë të Nenit 66/1 të KDS, dënohet me gjobë në masën 100.000 (njëqind mijë) lek. Në

aplikim të Nenit 136/1.a të KDS, gjoba shlyhet në masën 50%.

7. Lojtari i KF "Burreli" U-17, Samuel Kola, për sjellje jo sportive ndaj zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 49/1/a të KDS, dënohet me 6 (gjashtë) ndeshje pezullim nga aktiviteti.

8. Zyrtari i KF "Brians" U-17, Kreshnik Ivanaj për protestë ndaj vendimeve të zyrtarit të ndeshjes, në bazë të Nenit 56/1/a) të KDS, dënohet me 2 (dy) ndeshje pezullim nga aktiviteti.

9. Rrëzimin e kërkesës së lojtarit të KF "Shkëndija DR" U-19, Etnik Kameri, si të pa bazuar në KDS dhe Rregulloret e tjera të FSHF.

10. Rrëzimin e kërkesës së lojtarit të KF "Kukësi" U-17, Ervis Patarrja, si të pa bazuar në KDS dhe Rregulloret e tjera të FSHF.

PRESIDENTI I SKËNDERBEUT

Takaj akuzon: Policia po fsheh provat e dhunës

Skandaloze dhe alarmante! Presidenti i Skënderbeut, Ardjan Takaj ka mbetur i tronditur pas vendimit të Komisionit të Disiplinës. Madje ai shkon më tej, duke akuzuar haptazi Policinë e Shtetit, që sipas kreut të klubit bardhekuq, po fsheh provat e dhunës. "Është skandaloze, policia po fsheh provat. Nuk më duhet fare dënimi i Kastriotit, por më intereson zbardhja e atij sulmi", deklaroi Takaj ekskluzivisht për "Panorama Sport". Kujtojmë se klubi i Kastriotit, pas rasteve të dhunës para ndeshjes me Skënderbeun, u dënua me 2 ndeshje për të luajtur në fushë asnjane dhe me 50 mijë lekë gjobë.



BARCELONA E GRUMBULLON

"El Clasico" në Kupë, Mesi do të jetë i gatshëm

Një sfidë si kjo, ai s'mund ta humbiste kurrë, vetëm nëse do të kishte probleme fizike vërtet serioze. Lionel Mesi, ai që shqetësoi Barcelonën gjatë ditëve të fundit, do të jetë një prej protagonistëve të "El Clasicos", në program në mbrëmje, e vlefshme për gjysmëfinalen e parë të Copa del Rey Rikuperimi u zyrtarizua që kur Leo Mesi ishte pjesë e grupit që u stërvit për ndeshjen me Real Madridin, ndaj Valverde nuk humbi kohë për a bërë pjesë të lojtarëve me të cilin do të përballtet nesër ndaj rivalëve të përjetshëm. Gjithsesi, një mungesë të Barcelona do të jetë. Ousmane Dembele nuk do të jetë i gatshëm pas shqetësimeve në kavigjete në ndeshjen ndaj Leganesit, por pritet që ai të rikuperojë për sfidën ndaj Atletikos.




Publikohen çështjet deri më 9 prill

KAS-i "harron" Skënderbeun, nuk dihet ende data e gjyqit

Në prononcimin e tij të fundit publik për këtë çështje, presidenti Ardjan Takaj u shpreh se gjyqi në KAS mes Skënderbeut dhe UEFA-s do të zhvillohet në muajin mars. Madje, Takaj u shpreh se janë caktuar edhe gjyqtarët që do të shqyrtojnë akimimin e korçarëve kundër dënimit të dhënë nga Apeli i UEFA-s, që la në fuqi ndëshkimin e 'Disiplinës', e cila i përjashtoi 10 vite nga kompeticionet europiane kampionët e Shqipërisë dhe e gjobiti me 1 milion euro. Por në përditësimin e fundit të seancave që KAS do të shqyrtojë, emri i Skënderbeut nuk figuron kund. Të paktën deri më 9 prill. Kjo është e disata herë që seanca gjyqësore më famëkeqe për sportin shqiptar nuk gjen hapësirë në listën e KAS-it, gjithnjë duke iu referuar deklaratave të bëra nga drejtuesit më të lartë të klubit korçar. Me këto ritme është e kotë të hamendësoh një datë fikse, por të gjitha gjasat janë që seanca të zhvillohet në përfundim të edicionit futbollistik kombëtar.

Fjalëkryqi (1)



HORIZONTAL

- 1. Hari spiuqe.
4. Janë toksike.
9. Gjysmë arrest.
10. Janë vende pa ne.
13. Johnny i Donnie Brasco.
15. Priten nga meridianë.
18. Me të nxjerrin një letër.
20. U verbua nga Askusia.
21. Një britmë në arenë.
22. Shkrimtari i J'accuse.
24. Si moral.
25. Nota e diapazonit.
26. Me dies në një liturgji.
27. Një mund të jetë edhe veprimi.
28. Eshhtë e re pas Krishtit.
29. Inicialet e Bergman aktore.
30. Ai i trëndafilut është i Umberto Eco-s.
32. Fise pa fe.

- 33. Një provë zjarr.
34. Eshhtë mjeshtri me... bakete.
37. Digjen po nuk u zbuluan.
39. Iglit te Lazio.
41. Kush del... mbështet.
42. Mund të jetë unik.
46. Ngrihen për atentate.
47. Janë fjetore në kazerma.
48. Altini mesfushor.
VERTIKAL
1. Fillojnë matanë.
2. Një Hans artist dadaist.
3. Eshhtë mjet rrethoror lundrimi.
5. Eshhtë ënjtje.
6. Lumi i Elizit.
7. Fillojnë mpirjen.
8. Eshhtë e gjithë Hëna.
10. Eshhtë qetësues për neurozat.
11. Taylor aktore.
12. Daniel i Robinson Crusoe.
14. Kështu janë skenat që mallëngjëjnë.
16. Eshhtë pjesë në skenë.
17. Lëvizje Ekologjike Lokale.
19. Përshkohej nga Leti.
22. Eshhtë muzika më e... kollajtje.
23. Grazia Cucinotta aktore.
24. Veriu pa ekstreme.
27. Janë tre në tricikël.
30. Scuola, regjisori italian.
31. Kufizojnë një metër.
34. Mbahet me inat.
35. Mbyllin kurse.
36. Ka një shpejtësi fantastike.
38. Laik kur s'është ai.
40. Një liqen i kripur.
43. Një mund të jetë fetar.
44. Eshhtë Iloj papagalli.
45. Në hyrje të sallës.
46. Priten në skaje.

Fjalëkryqi (2)


HORIZONTAL

- 1. Janë lokale me kubiste.
9. Me të nxjerrin në tapë.
11. Polanski regjisor.
12. Qeni i famshëm i Odiseut.
15. Mbeten në fund.
16. Gabon në ekstreme.
18. Rreh në kufij.
19. Eshhtë vepër për një... vepër.
23. Janë udhëtime për në një vend të shenjtë.
25. Dinë shumë gjuhë.
26. Një mendim.
27. Famëkeqi Capone.
28. Kush i kthen... të braktis.
29. Kisha pa zë.
30. I fjuari i kukullës Barbie.
32. Ritet pa re.
33. Një brinjë në skuadër.
35. Emri i Zola.


- 37. Eshhtë moshë e të miturit.
40. Një dispozitiv koke.
41. Janë strehë për barinj.
42. Fillojnë aksionin.
43. Eshhtë ai që nuk qesh.
45. Të parat në ambient.
46. Gjysmë teorie.
47. Një binar.
48. Djeg kur bie.

VERTIKAL


- 1. Barrymore aktore.
2. Tiriq që qe tenist.
3. Ekstreme në studim.
4. Eshhtë kleri me papën.
5. Ndezur në aparaturë.
6. Kaluar në krye.
7. Janë racë e pastër.
8. Një treg pa re.
10. Duhet fituar me djersë.
13. Një drithë për sake.
14. Lëvizin pasi mendohen shumë.
16. Janë sfera për bingo.
17. Eshhtë më pak se nxehtësi.
19. Gibson aktor.
20. Tregonin shkëlqer dikur.
21. Mund të jenë fetare të tilla.
22. Kush nuk ka... nuk i ecën.
23. Një sherr në shtyp.
24. Një lidhëz.
25. Mund të jenë cigaresh.
29. Mund të bëjë zoom.
31. Ndërmarrje Industriale Mirditë.
33. Pak konkrete.
34. Eshhtë i mirë me shokë shumë.
36. Artikull për shumë francezë.
38. Kanto kur nuk... ka.
39. Muzika me jam session.
44. Mbyllin një sherr.
45. të fundit në sirtar.




Gjeni ndryshimin



Dy figurat kanë ndryshime nga njëra-tjetra



Përgjigja, ja cilat janë ndryshimet e figurave



PËRGJEGJET E FJALËKRYQEVE TË NUMRIT TË KALUAR

FJALËKRYQI (1)


FJALËKRYQI (2)

SUDOK



Plotësoni vendet bosh në mënyrë që çdo kolonë të ketë numrat nga 1-9

Përgjigje e sudokut të numrit të kaluar



Argëtim filozofik

-Trimëria me të drejtë është vlerësuar si cilësia e parë njerëzore...sepse ajo është cilësia që i garanton të tjerat.
-Kritika mund të mos jetë e pranueshme, por është e nevojshme. Ajo përmësh të njëjtin funksion që ka dhimbja në trupin njerëzor. Ajo tërheq vëmendjen ndaj gjendjes jo të shëndoshë të gjërave.
-Çdokush e ka ditën e tij dhe disa ditë zgjatim më shumë se të tjerat.
-Për keq apo për mirë, sotërimin i ajrit është sot shprehja ekstreme e fuqisë ushtarake. Flotat dhe ushtritë, sado vitale dhe të rëndësishme, duhet të pranojnë një rang më të ulët.

KRIPTOSKEME

KRIPTOSKEME

Përgjigja e numrit të djeshëm



Dhënie të mençura

- Sado e bukur të jetë strategjia, unë herë pas here veshtror rezultatet.
- Unë gjithmonë shmang dhënien paraakte të profecive, sepse është shumë më mirë të profetizosh pasi një zhvillim ka ndodhur tashmë.
- Jam gjithnjë gati të mësoj sado e asnjëherë nuk

- më pëlqen të më japin mësim.
• - Sigurisht që nuk jam një nga ata që kanë nevojë të më nxitin. Në fakt, nëse diçka jam, atëherë jam vetë nxitja.
• - Më pëlqejnë derrat. Qentë na shikojnë në nga lart. Macet na shikojnë nga poshtë. Derrat na trajtojnë si të barabartë.

